



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 19 regjistër (JR)  
Datë 20.04.2022

Nr. 34 i vendimit  
Datë 16.07.2024

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 16.07.2024, ditën e martë, në orën 10.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare gjyqësore Arjela Vllaçaj, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 19/2022 (JR), datë 20.04.2022, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 513, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet C, Ç, D, F e në vijim të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 6 e në vijim i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”)<sup>1</sup>, dhe kreu hetimin e plotë administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke arritur në konkluzionet si më poshtë:

2.1 Në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë: *Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e germave “a”, “b” dhe “c” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr.84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vërtetohen shkaqet që neni D i Aneksit të Kushtetutës i ka parashikuar të tilla që të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Në konkluzion, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.*

2.2 Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës: *Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*

2.3 Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *Trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes, arrin në*

---

<sup>1</sup> Shih paragrafin 7 të vendimit të Komisionit.

konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues, në kuptim të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

3. Në përfundim, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “c” dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 513, datë 25.02.2022, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pukë”.

## II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

4. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 513, datë 25.02.2022, me pretendimin se ky vendim është marrë në shkelje të parimeve themelore procedurale të parashikuara nga nenet 42 e 179/b, pika 2, të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, nenit 4, pika 5, nenit 6, nenit 38, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe parimeve të sigurisë juridike, afatit të arsyeshem dhe arsytimit të vendimit, por gjithashtu edhe rezultat i vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të provuara gjatë procesit administrativ për vlerësimin e kriterit të pasurisë.
5. Subjekti i rivlerësimit e shoqëroi ankimin e tij me akte shkresore<sup>2</sup> dhe, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar nga Kolegji: (i) marrjen e provave të kërkuara bashkëlidhur ankimit; (ii) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (iii) ndryshimin e vendimit nr. 513, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.
6. Shkaqet procedurale të ankimit, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

6.1 Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për t’u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj gjetjeve që mund të çojnë në shkarkimin nga detyra, duke shkelur parimet e procesit të rregullt ligjor, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

6.2 Subjektit të rivlerësimit nuk janë bërë të njohura nga Komisioni provat mbi të cilat ka nxjerrë të dhënat apo konkluzionet e pasqyruara në dokumentin “Raport përfundimtar”, apo më pas në vendim, dhe nuk rezulton as të jetë shprehur me vendimmarrje për administrimin ose jo të tyre, sipas nenit 183 të Kodit të Procedurës Civile.

---

<sup>2</sup> Bashkëlidhur ankimit janë paraqitur aktet: i) raport i ekspertit auditues, i pavarur ligjor, S. Sh., me nr. licence nr. {\*\*\*}, datë 12.04.2022; (ii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot, datë 04.02.2022, “Për bazën e vlerësueshme”, për S.H., për periudhën 26.03.2005 – 05.08.2005; (iii) vërtetim “Për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, për S.H., për periudhën 16.04.2002 – 26.03.2005, punëdhënësi Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër; (iv) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2022, i Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, mbi pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të S. H., për periudhën 16.04.2002 – 26.03.2005; (v) vërtetim “Për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare”, për S. H., për periudhën 2006 – 2011 dhe 2015 – 2021, punëdhënësi Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë; (vi) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2022, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pukë, mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha, për periudhën 01.01.2014 – 31.12.2020; (vii) vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2022, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pukë, mbi të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit në periudhën 01.01.2003 – 28.02.2007.

6.3 Komisioni ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka analizuar e vlerësuar të gjitha pretendimet e provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, përfshirë dhe aktet e administruara kryesisht prej tij.

6.4 Nuk janë zbatuar rregullat për caktimin e ekspertit të parashikuara të nenin 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, të cilët duhet t'i ishin bërë të njohur subjektit të rivlerësimit për t'u shprehur mbi konfliktin e interesit mbi ta, sipas nenit 224/c, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile.

6.5 Seanca e datës 22.02.2021 ishte një seancë tërësisht formale dhe pa asnjë dobi për procesin, në të cilën relatori bëri një përmbledhje të të njëjtave konstatime, si në dokumentin "Raport përfundimtar", dhe pyetjet e anëtarëve të trupit gjykues nuk kishin lidhje me çështjet që do të çonin në ngritjen e prezumimit ligjor mbi marrjen e masës disiplinore të shkarkimit.

6.6 Komisioni ka cenuar parimin e proporcionalitetit në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi arsyet e dhëna nga Komisioni në vendimin e marrë nuk janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tillë shkarkimi.

6.7 Komisioni ka vepruar me standard të dyfishtë për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi në disa vendime të tjera, anëtarët e trupit gjykues E. Ç. dhe R. I., kanë mbajtur qëndrime të ndryshme.

6.8 Komisioni, në konkluzionin se subjekti ka qenë kontradiktore në thëniet e saj, nuk ka mbajtur në konsideratë një rrethanë madhore të ndodhur gjatë procesit të rivlerësimit, siç është humbja e jetës së vëllait të saj, me detyrë punonjës policie, më datë 28.09.2021.

6.9 Komisioni ka gabuar në aplikimin e masës disiplinore *shkarkim nga detyra*, sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi konkluzioni për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë rezulton tërësisht i pabazuar dhe i pavërtetë.

6.10 Komisioni i ka cenuar vlerën e dinjitetit njerëzor duke zhvilluar procesin e rivlerësimit kalimtar të saj për një periudhë të paarsyeshme kohe dhe me komunikime të papërshtatshme e në kundërshtim me nivelin minimal të etikës zyrtare dhe të ndjeshmërisë.

6.11 Vendimi i Komisionit cenon parimin e sigurisë juridike, si për shkak të zbatimit të keq dhe jo uniform të ligjit, ashtu dhe për shkak të mbledhjes së paligjshme të të dhënave.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

7.1 Në lidhje me *shuma të kursyera deri në vitin 2015 dhënë prindërve*, subjekti i rivlerësimit pretendon se: (i) Komisioni, në mënyrë të gabuar, i ka konsideruar gjendjet *cash* të deklaruara ndër vite, si kursime të gjithë familjes, duke i përfshirë si të tilla në analizën financiare; (ii) Pasaktësitë në deklarime kanë konsistuar vetëm në mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore dhe në plotësimin e deklaratës fillestare.

7.2 Për pasurinë *apartament në përdorim në vitet 2008 – 2012, në rrugën "{\*\*\*\*}"*, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarimin e pasurisë së krijuar nga prindërit,

pasi ajo është ndarë me gjendje civile prej tyre, që në vitin 1993 dhe se mosdeklarimi i përdorimit të apartamentit në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk është bërë me qëllim fshehjen e tij.

7.3 Në lidhje me analizën financiare të pasurisë *apartament në përdorim në vitet 2008 – 2012, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë*, subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendimet si vijojnë:

7.3.1 Në analizën financiare nuk është përfshirë shuma e rezultuar në fund të vitit 2002, që përbën kursimet e të gjithë familjes, përfshirë dhe kontributin e subjektit të rivlerësimit, dhe se Kolegji ka qëndrim të konsoliduar në kryerjen e analizës financiare të personave të lidhur apo të tjerë të lidhur, e cila bëhet kumulative për çdo vit, në ndryshim nga ajo subjektit të rivlerësimit, që kushtëzohet nga deklaratimet periodike.

7.3.2 Në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit, investuar nga babai dhe vëllai, në total në vlerën 724.953 lekë.

7.3.3 Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova mbi mundësinë financiare të huadhënësit R. M.

7.3.4 Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në vitin 1998, në shumën 119.793 lekë, pasi paga e saj në këtë vit ka qenë 257.555 lekë dhe jo 137.762 lekë, siç pasqyrohet nga Komisioni.

7.3.5 Nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e vëllait, i punësuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në shumën 1.053.809 lekë, dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, në shumën 3.992.267 lekë.

7.3.6 Për periudhën deri në fund të vitit 2002, nuk janë përfshirë të ardhurat e vëllait në shumën 188.764 lekë, nga punësimi i tij pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, të cilat nga 435.230 lekë të përlllogaritura nga Komisioni duhet të ishin 623.994 lekë.

7.3.7 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm mundësinë e krijimit të depozitave dhe derdhjeve të babait në “Raiffeisen Bank” ShA dhe në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, nga viti 2003 deri në vitin 2016.

8. Në datën 10.07.2024, pas njoftimit të marrë për caktimin e datës së gjykimit të çështjes në dhomë këshillimi, subjekti i rivlerësimit dorëzoi pranë Kolegjit një material shkresor të titulluar “Parashtrime”, të pashoqëruar me akte shkresore.

### **III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

#### *A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit*

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni

179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Flutura Hoxha, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>3</sup> nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 513, datë 25.02.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
12. Trupi gjykues i Kolegjit, për të konkluduar mbi formën e gjykimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkelje procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, analizoi fillimisht shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim.
13. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se: *Komisioni i ka cenuar të drejtën për t’u mbrojtur në mënyrë efektive ndaj gjetjeve që mund të çojnë në shkarkimin nga detyra, duke shkelur parimet e procesit të rregullt ligjor, kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni kur konstaton apo krijon bindjen se nuk është përmbushur një detyrim ligjor i caktuar, duhet t’ia bëjë me dije këtë mangësi apo situatë subjektit, e aq më tepër nëse ky element konsiderohet se mund të çojë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në mbështetje të këtij shkak ankimor, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar faktin se, megjithëse kishte depozituar pretendime, deklarime dhe prova shtesë deri në ditën e zhvillimit të seancës së vetme dëgjimore, ishte e paqartë me qëndrimin që Komisioni do të mbante ndaj këtyre pretendimeve dhe provave. Ajo nuk u ndërgjegjësua asnjëherë se cila do të ishte çështja problematike që do të determinonte vendimmarrjen dhe, vetëm nga*

---

<sup>3</sup> Vendimi i Komisionit nr. 513, datë 25.02.2022, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.03.2022, konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 31.03.2022, sipas lajmërim marrjes së shërbimit postar. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 14.04.2022.

përmbajtja e vendimit, erdhi në dijeni të faktit se masa disiplinore e shkarkimit lidhej kryesisht me “të ardhurat dhe pasurinë e personit të lidhur”.

13.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se qëllimi i hetimit administrativ është të njoftojë dhe t’i bëjë të ditur subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara kanë mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur konstatimet e Komisionit, në përfundim të fazës së hetimit administrativ dhe jo që ato të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit. E kundërta, pra, nëse Komisioni do të kishte përcaktuar që me rezultatet e hetimit, referencën apo pasojën ligjore, ky fakt do të përbënte paragjykim të vendimit nga ana e Komisionit, që bazuar në nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i zhvillon bisedimet për marrjen e vendimit pas zhvillimit të seancës dëgjimore. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se Komisioni ka përmbushur detyrimin për t’i bërë me dije subjektit të rivlerësimit çështjet për të cilat provat kanë pasur nivelin e provueshmërisë sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, ndër të cilat edhe mungesa e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj për blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës respektive, e tashmë mbetej detyrë e tij të vlerësonte mënyrën se si do të realizonte mbrojtjen, si dhe dokumentacionin që duhet të paraqiste për të provuar të kundërtën për gjetjet që kanë rezultuar nga hetimi administrativ. Nga të dhënat e hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, dhe pasi është njohur me dosjen e procesit të rivlerësimit dhe ka marrë kopje të saj<sup>4</sup>, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë elektronikisht, më datë 11.02.2022, prapësime dhe dokumente mbështetëse, duke dhënë sqarime për të gjitha pikat e barrës së provës të dërguar nga Komisioni. Veç kësaj, subjekti të rivlerësimit i është lënë mundësia të paraqesë prova shtesë deri në ditën e seancës dëgjimore. Në seancën dëgjimore të datës 22.02.2024, relatori i çështjes parashtrou gjetjet e rezultateve të hetimit administrativ dhe subjekti i rivlerësimit ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me to, si dhe u është përgjigjur pyetjeve të bëra nga anëtarët e trupit gjykues dhe nga Vëzhguesi Ndërkombëtar. Pas këtij momenti, trupi gjykues është tërhequr në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkak, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit është njohur me të gjitha gjetjet paraprake të Komisionit dhe për të cilat i është garantuar e drejta për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur në mënyrë efektive.

14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se: *Komisioni nuk i ka bërë të njohura se mbi cilat prova ka nxjerrë të dhënat apo konkluzionet e pasqyruara në dokumentin “Raport përfundimtar”, apo më pas në vendimin e marrë, dhe nuk rezulton as të jetë shprehur me ndonjë vendimmarrje për administrimin ose jo të tyre sipas nenit 183 të Kodit të Procedurës Civile*<sup>5</sup>.

14.1 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së rezultateve të hetimit, konstaton se konkluzionet paraprake të Komisionit janë bazuar në fakte që rrjedhin nga dokumentacioni i mbledhur gjatë hetimit administrativ, konkretisht si vijojnë: (i) konstatimet mbi “Shumat e kursyera dhënë prindërve deri në vitin 2015”, paraqitur në pikën 2 të rezultateve të hetimit,

---

<sup>4</sup> Deklaratë e datës 04.02.2022, e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në të cilën konfirmohet njohja me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike të procesit të rivlerësimit.

<sup>5</sup> Neni 183 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se: “Gjykata, me vendim, lejon marrjen e provave dhe kur është rasti edhe mënyrën e marrjes së tyre. Refuzimi i marrjes së provës së kërkuar duhet të arsyetohet nga gjykata, pa e paragjykuar çështjen”.

bazohen në deklaratat e interesave periodikë privatë të periudhës 2003 – 2016, që në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, kanë fuqinë e provës, si dhe në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ndaj pyetësorit standard (nr.1) dhe pyetësorit 3 të Komisionit; (ii) konstatimet mbi “Pasuri në qytetin e Pukës”, paraqitur në pikën 3 të rezultateve të hetimit, mbështeten në praktikën e përcjellë nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pukë dhe në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ndaj pyetësorit 2 të Komisionit; (iii) konstatimet mbi “Apartament në përdorim në vitet 2008 – 2012”, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, pasqyruar në pikën 4 të rezultateve të hetimit, bazohen në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ndaj 4 (katër) pyetësorëve të Komisionit, deklaratat e interesave periodikë privatë të viteve 2007 – 2010, si dhe përgjigjen e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë; (iv) konstatimet e tjera që lidhen me depozitat bankare dhe derdhjet bankare, pasqyruar në pikën 5 të rezultateve të hetimit, mbështeten në të dhënat bankare të babait të subjektit të rivlerësimit pranë “Raiffeisen Bank” ShA, “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ndaj pyetësorit 4 të Komisionit. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se, më datë 04.02.2022, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>6</sup> se është njohur dhe ka marrë në dorëzim, pas asnjë vërejtje, të gjithë dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike të hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni. Edhe në përmbajtje të vendimit objekt shqyrtimi, përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se, për secilën pasuri të hetuar, rezulton të jetë pasqyruar dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë procesit të hetimit administrativ, përfshirë edhe dokumentacionin e sjellë nga subjekti<sup>7</sup> në përgjigje të pyetësorëve, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit apo shpjegime të dhëna në seancë dëgjimore. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni duhet të disponojë me vendim të ndërmjetëm mbi pranueshmërinë e çdo prove të paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se kuadri kushtetues dhe ligjor që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë se në këtë proces është subjekti i rivlerësimit që ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, e në këtë kuptim, paraqitja e atyre dokumenteve dhe akteve që subjekti vlerëson se mbështesin dhe plotësojnë mbrojtjen e tij, është në çmimin e vetë subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, Komisioni ka administruar të gjitha shpjegimet dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, dhe se asnjë prej këtyre akteve nuk është refuzuar prej tij. Po ashtu, nuk rezulton që gjatë seancës dëgjimore nga subjekti i rivlerësimit të jenë parashtruar kërkesa apo debatuar çështje që lidhen me administrimin e provave që subjekti ka paraqitur në Komision.

15. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *Komisioni ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk ka analizuar e vlerësuar të gjitha pretendimet e provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe aktet e administruara kryesisht prej tij në funksion të konstatimit të gjendjes faktike, madje për fakte të caktuara në vendim pretendohet se nuk është depozituar asnjë provë, ndërkohë që nga ana e subjektit kanë qenë depozituar prova për atë qëllim. Analiza e fakteve e bërë nga subjekti i rivlerësimit në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, në vendim paraqitet e selektuar, duke cituar vetëm një pjesë të tyre, të cilat janë rrëzuar pa arsytim në nivelin minimal që kërkon standardi i procesit të rregullt ligjor.*

<sup>6</sup> Deklaratë e subjektit të rivlerësimit e datës 04.02.2022.

<sup>7</sup> Shih paragrafët 2.5, 2.7, 2.8, 2.13, 2.14, 2.18, 3.1, 3.6, 3.9, 4.2, 4.6, 4.9, 4.10, 4.12, 4.16, 4.20, 5.2, 6.2, të vendimit të Komisionit.



Në analizë të këtij pretendimi, nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se, në paragrafin 22, në faqen 5 të tij, Komisioni shprehet se ka marrë në analizë, ndër të tjera, edhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të dorëzuara nëpërmjet postës elektronike, dhe ato të dhëna gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si dhe provat shkresore apo dokumentet e administruara nga organet publike e private, në përputhje me nenet 49 e 50 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vëren se, për secilën pasuri të hetuar, është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në vendim, qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorëve dhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit dhe vlerësimi i Komisionit lidhur me to. Fakti që pretendimet apo provat e paraqitura nuk janë analizuar e vlerësuar sipas vlerësimit të subjektit të rivlerësimit, nuk përbën shkak *a priori* se ato janë anashkaluar, përkundrazi tregon se sqarimet dhe provat e sjella, pasi janë shqyrtuar nga Komisioni, në këndvështrimin e tij nuk kanë mundur të provojnë faktin për të cilin janë paraqitur. Edhe fakti që në vendimin e Komisionit nuk është pasqyruar e gjithë analiza e subjektit të rivlerësimit në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, nuk provon mungesë analizimi të saj, ndërsa fakti nëse ato janë vlerësuar drejt ose jo, është objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit. Sa i takon pretendimit të subjektit që, për fakte të caktuara në vendim, thuhet se nuk është paraqitur ndonjë provë, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk referon ndonjë fakt konkret për të cilin Komisioni të ketë mbajtur këtë qëndrim, duke e pamundësuar verifikimin e tij.

16. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *Komisioni duhet të zbatonte rregullat për caktimin e ekspertit, të parashikuara të nenin 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, të cilët duhet t'i ishin bërë të njohur subjektit të rivlerësimit, për t'u shprehur mbi konfliktin e interesit mbi ta, sipas nenit 224/c, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile*<sup>8</sup>. *Subjekti i rivlerësimit e lidh këtë pretendim me faktin se anëtarët e Komisionit nuk kanë njohuri të posaçme në fushën e kontabilitetit për të kryer analiza financiare.* Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë nuk është një proces vlerësimi vetëm financiar, por një balancë mes interpretimit ligjor dhe analizës financiare, për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe përmbushjes së detyrimeve financiare të subjektit të rivlerësimit e personave të lidhur me të. Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur Komisionin dhe Kolegjin me të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve, bazuar në një analizë të saktë dhe shteruese të provave të administruara. Komisioni dhe Kolegji në shqyrtimin e çështjeve asistohen nga Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbëhet nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, detyrat e të cilëve rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016 dhe jo sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile mbi ekspertët. Edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me identitetin e këshilltarëve, me qëllim verifikimin e ekzistencës së mundshme të konfliktit të interesit, nga trupi gjykues vlerësohet i pabazuar, pasi këshilltarët janë pjesë e strukturës ndihmëse të Komisionerëve dhe detyrat e tyre janë të caktuara me ligj, në çdo rast duke pasur parasysh edhe përcaktimet e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publikë”<sup>9</sup>, i ndryshuar.

<sup>8</sup> Në këtë nen përcaktohet se: “Përjashtimi i ekspertit nga pjesëmarrja e tij në gjykim bëhet kur janë kushtet e përcaktuara prej nenit 72 të këtij Kodi”.

<sup>9</sup> Neni 4 parashikon se: “2. Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen

17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *seanca e datës 22.02.2021 ishte një seancë tërësisht formale dhe pa asnjë dobi për procesin. Sipas subjektit, relatori bëri një përmbledhje të të njëjtave konstatime si në dokumentin “Raport përfundimtar”, dhe pyetjet e anëtarëve të trupit gjykues nuk kishin lidhje me çështjet që do të çonin në ngritjen e prezumimit ligjor mbi marrjen e masës disiplinore të shkarkimit.* Në kuadër të analizës së këtij pretendimi, nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 22.02.2021, trupi gjykues vëren se, pas prezantimit të gjetjeve nga relatori i çështjes dhe paraqitjes së parashtrimeve nga subjekti i rivlerësimit, anëtarët e trupit gjykues dhe Vëzhguesi Ndërkombëtar i kanë drejtuar një sërë pyetjesh subjektit të rivlerësimit sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Seanca dëgjimore, në vlerësimin e trupit gjykues nuk mund të konsiderohet se ka qenë formale, për sa kohë subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën dhe i është dhënë mundësia të kundërshtojë çdo gjetje të Komisionit të relatuar nga ana e relatorit të çështjes, të shpjegojë të gjitha faktet dhe provat e mbledhura në kuadër të kalimit të barrës së provës nga Komisioni. Në vlerësim të trupit gjykues, do të ishte një paragjykim për subjektin, nëse anëtarët e trupit gjykues të Komisionit do të shpreheshin në seancë dëgjimore se cilat nga pretendimet e tij të paraqitura në prapësime ishin gjetur të bazuara e cilat jo, në një kohë që sipas nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, bisedimet për marrjen e vendimit zhvillohen me dyer të mbyllura në dhomë këshillimi. Nga ana tjetër, nuk rezulton që vetë subjekti të ketë shprehur ndonjë kundërshti në lidhje me pyetjet apo qëndrimin e anëtarëve të trupit gjykues, fakte këto që e bëjnë të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.
18. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Komisioni ka vepruar me standard të dyfishtë për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke iu referuar disa vendimeve të Komisionit, ku anëtarët e trupit gjykues E. Ç. dhe R. I., kanë mbajtur qëndrime të ndryshme<sup>10</sup>.* Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se Kolegji shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese<sup>11</sup>, vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi, në përputhje edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: *“Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor”.* Nuk është roli i Kolegjit, madje edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme, në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura në to, të krahasojë vendimet e ndryshme të dhëna nga Komisioni, për subjekte të ndryshme. Çdo vendimmarrje e ankimuar e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e tij, bazuar në veçantitë e fakteve të dala nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike.
19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Komisioni ka cenuar parimin e proporcionalitetit në dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi arsytet e dhëna nga Komisioni në vendimin e marrë nuk*

---

*edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; c) një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit”.*

<sup>10</sup> Vendim i Komisionit nr. 327, datë 23.12.2020 dhe nr. 43, datë 18.07.2018.

<sup>11</sup> Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës: *“5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”.*

janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar një masë të tilla shkarkimi. Këtë pretendim, subjekti e lidh me faktin se pasaktësia e deklaratës së pasurisë vetting, në lidhje me gjendjen e cash-it në banesë, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi: (i) pasaktësia nuk ka qenë e qëllimë, sepse në momentin e deklaramit ajo ka jetuar me prindërit në Pukë; (ii) ka kontribuar e mbështetur prindërit e saj, të cilët janë në moshë, pensionistë, duke ruajtur traditën e familjes shqiptare; (iii) kjo gjendje cash-i nuk ka shërbyer në asnjë moment për krijimin prej saj të ndonjë pasurie të paluajtshme, e vetmja pasuri është apartamenti i blerë nga babai në vitin 2007. Sipas subjektit të rivlerësimit, jo në pak raste Komisioni dhe Kolegji kanë arsyetuar se pasaktësitë në likuiditete, kur nuk është provuar se ato kanë shërbyer si burim për krijimin e një pasurie, nuk do të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, parimi i proporcionalitetit, i përmendur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konkluduar se subjekti gjendet në kushtet e përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të ligjit nr. 84/2016, duke disponuar me dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Sikurse vihet re, masa disiplinore nuk lidhet vetëm me pasaktësinë e deklaratës së pasurisë vetting, por lidhet edhe me mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën (-) 5.257.890 lekë dhe fshehjen e pasurisë. Balanca negative e burimeve të ligjshme në një vlerë relativisht të lartë dhe konkluzioni tjetër që lidhet me fshehjen e pasurisë sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin e trupit gjykues e pamundësojnë në rastin konkret zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Komisioni, në konkluzionin e tij se subjekti ka qenë kontradiktore në thëniet e saj, nuk ka mbajtur në konsideratë një rrethanë madhore të ndodhur gjatë procesit të rivlerësimit, siç është humbja e jetës së vëllait të saj, me detyrë punonjës policie më datë 28.09.2021, ndërkohë që asaj i duhej ti jepte përgjigje për pyetjet e pyetësorit nr.2 të Komisionit, të datës 11.10.2021, e në vazhdimësi edhe të pyetësorëve të tjerë, si dhe të paraqiste dokumentacion provues.* Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit i ka dërguar Komisionit përgjigjet e pyetësorit nr. 2, më datë 19.10.2021, ndërkaq nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë ndonjë kërkesë për shtyrje të afatit të kthimit të përgjigjeve të këtij pyetësori, sikurse ka vepruar në rastin e përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, ku Komisioni, pas kërkesës së saj, ka shtyrë afatin e kthimit të përgjigjeve deri në datën 24.11.2021, apo dhe në rastin e paraqitjes së prapësimeve mbi rezultatet e hetimit, duke zgjatur afatin e paraqitjes së provave deri në seancën dëgjimore. Paraqitja e një pretendimi të tillë për herë të parë në ankim, i pangritur në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, kur subjekti i rivlerësimit u njoh me barrën e provës, apo në seancë dëgjimore, në vlerësimin e trupit gjykues e bën këtë pretendim të pabazuar.
21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se: *Komisioni i ka cenuar vlerën e dinjitetit njerëzor, duke zhvilluar procesin e rivlerësimit kalimtar të saj për një periudhë të paarsyeshme kohe, dhe me komunikime të papërshtatshme dhe në kundërshtim me nivelin minimal të etikës zyrtare dhe të ndjeshmërisë. Komunikimi është zhvilluar në rrugë elektronike dhe dërguesi i postës elektronike ka qenë anonim, dhe duke e përdorur si një mjet përgjatë gjithë procesit.* Në shqyrtim të këtij pretendimi të subjektit të

rivlerësimi, referuar të dhënave të hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se procesi i rivlerësimi për subjektin e rivlerësimi Flutura Hoxha ka nisur me shortimin e saj më datë 16.12.2019<sup>12</sup> dhe, në një hark kohor prej 2 vjet, 1 muaj e 12 ditë, nga kjo datë deri në datën e përfundimit të hetimit administrativ, më datë 28.01.2022, Komisioni ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me subjektin e rivlerësimi përmes dërgimit të 4 (katër) pyetësorëve dhe administrimit të përgjigjeve të subjektit të rivlerësimi lidhur me to. Trupi gjykues vëren se, gjatë kësaj periudhe, Komisioni ka pranuar kërkesat e subjektit të rivlerësimi për zgjatje të afatit të kthimit të përgjigjeve të pyetësorit 3, si dhe i ka krijuar mundësinë për paraqitjen edhe në seancë dëgjimore të dokumenteve në mbështetje të prapësimeve të saj. Një kohëzgjatje e tillë, në një periudhë gjatë së cilës ka pasur ndërveprim aktiv të subjektit të rivlerësimi dhe Komisionit, dëshmon se ka qenë kohë më se e mjaftueshme dhe në raporte të barabarta me subjekte të tjerë rivlerësimi. Nga verifikimi i pyetësorëve drejtuar subjektit të rivlerësimi gjatë hetimit administrativ, rezultateve të hetimit dhe procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 22.02.2022, ndonëse subjekti i rivlerësimi e paraqet për herë të parë një pretendim të tillë në ankim pa referuar ndonjë rast konkret, nga trupi gjykues nuk konstatohet gjuhë komunikimi e papërshtatshme, përkundrazi, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, që në hyrje të tyre, subjekti i rivlerësimi është shprehur: *“Paraprakisht dëshiroj të vlerësoj maksimalisht çdo përpjekje të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për mbarëvajtjen e këtij procesi vlerësimi”*. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimi mbi komunikimin në rrugë elektronike gjatë procesit të rivlerësimi, trupi gjykues sjell në vëmendje se mënyra e komunikimit gjatë procesit të rivlerësimi është parashikuar nga neni 46 i ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit njoftimi dhe çdo komunikim gjatë procesit të rivlerësimi bëhet në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimi, që është dhënë në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në kushtet kur organi i ngarkuar me kryerjen e procesit të rivlerësimi në shkallë të parë përcaktohet me ligj dhe është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pretendimi se dërguesi i postës elektronike ka qenë anonim, mbetet i pakuptimtë.

22. Subjekti i rivlerësimi pretendon se: *vendimi i Komisionit cenon parimin e sigurisë juridike, si shkak të zbatimit të keq dhe jo uniform të ligjit, ashtu dhe për shkak të mbledhjes së paligjshme të të dhënave. Sipas subjektit të rivlerësimi, masa e dhënë shkarkim nga detyra duke iu referuar parashikimeve të nenit D, pika 5 e Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, është tërësisht e padrejtë, e pabazuar, dhe pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Ky konkluzion i padrejtë i Komisionit sjell pasoja edhe në planin moral, pasi shkarkimi nga detyra, pas 23 vitesh punë si gjyqtare, përbën diskriminim dhe vendos kufizime për promovim apo për aplikime në pozicione punë në sistemin e drejtësisë, nëse nuk kalohet me sukses procesi i rivlerësimi. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se interpretimi i rastit të subjektit të rivlerësimi, nën rregullimin ligjor të parashikuar nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nuk cenon parimin e sigurisë juridike të garantuar nga Kushtetuta e Shqipërisë. Shkaqet mbi bazën e të cilave mund të jepet masa e shkarkimit nga detyra për kriterin e pasurisë, janë ato të parashikuara nga neni 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, ku në rastin konkret Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Gjithashtu, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimi gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, që përbën një ndër rastet e deklaramit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Sa i takon*

<sup>12</sup> <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-16-dhjetor-2019/19/>

pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me mbledhjen e paligjshme të të dhënave, ndonëse subjekti i rivlerësimit nuk i referohet në mënyrë konkrete ndonjë të dhëne të tillë, nga të dhënat e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se mbledhja e të dhënave nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit ka konsistuar në mbledhjen e informacioneve nga institucione publike dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, në përputhje me parashikimet e nenit 50, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi i Komisionit sjell kufizime për promovim apo aplikime në pozicione pune në sistemin e drejtësisë, trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi nuk i ka mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për t'u promovuar apo për të punuar, por ka kufizuar vetëm ushtrimin e funksioneve në sistemin e gjyqësor, sipas dispozitës kushtetuese, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit gëzon të gjitha të drejtat që të aplikojë në pozicione pune sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

23. Sa u takon akteve shkresore që subjekti i ka bashkëlidhur ankimit të tij, analiza për pranueshmërinë e tyre u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja "a" e të njëjtit ligj, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision. Gjithashtu, në vendimmarrjen e trupit gjykues mbi kërkesat e subjektit të rivlerësimit, për marrjen akteve shkresore në cilësinë e provave të reja, u mbajtën në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues çmoi se aktet shkresore bashkëlidhur ankimit nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces, referuar dispozitave të sipërcituara ligjore, bazuar në analizën e mëposhtme:

(i) Lidhur me vërtetimet për bazën e vlerësueshme, të paraqitur me qëllim vërtetimin e të ardhurave të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. S. H., për periudhën 26.03.2005 – 05.08.2005, nga punëdhënësi Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, dhe për periudhat 2006 – 2011 dhe 2015 – 2021 nga punëdhënësi Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, konstatohet se janë akte të administruara në fashikullin e Komisionit dhe referojnë fakte të njohura nga ky i fundit. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se duhet të përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese për zgjidhjen e çështjes dhe të refuzohen për t'u marrë si prova të reja, bazuar edhe në nenin 49, pika 6, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.

(ii) Lidhur me vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 12.04.2022, të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, sipas të cilit vërtetohet se z. S. H., për periudhën 16.04.2002 – 26.03.2005, ka paguar rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore, dhe vërtetim mbi bazën e vlerësueshme e pagën neto mesatare, të paraqitur me qëllim vërtetimin e të ardhurave të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. S. H., për periudhën 16.04.2002 – 26.03.2005, konstatohet se këto akte paraqiten për herë të parë në Kolegj. Në kushtet kur fakti që kërkohet të provohet, rezulton i evidentuar gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është paraqitur ndonjë argument apo arsye mbi pamundësinë e paraqitjes së tyre gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerëson se këto akte nuk mund të pranohen në cilësinë e provës në këtë fazë të procesit, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, pavarësisht mosplotësimit të këtij kriteri formal, në një qëndrim garantist, trupi gjykues

vlerëson se, edhe nëse këto akte do të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë, të ardhurat nga paga neto, në vlerën 1.052.907 lekë, që përftohen nga këto dokumente, do të afektonin analizën e vitit 2003, duke bërë që rezultati pozitiv prej 2.880.982 lekësh të bëhej 3.205.311 lekë, rezultati për vitin 2004 do të përmirësohej, duke zbritur balancën negative nga (-) 1.421.967 lekë, në (-) 974.271 lekë dhe për vitin 2005 do të përmirësonte rezultatin, por duke mbetur po në vlera negative nga (-) 980.983 lekë në (-) 665.106 lekë.

(iii) Lidhur me raportin e ekspertit auditues të pavarur, të datës 12.04.2024, të paraqitur me qëllim vërtetimin e mundësisë financiare të blerjes së apartamentit në Tiranë në vitin 2007, me dhe pa kontributin e subjektit të rivlerësimit, si dhe depozitat bankare të babait të saj, z. B. H., trupi gjykues vëren se konstatimet e aktit të ekspertimit janë pjesë përbërëse e pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, si në ankim, ashtu dhe në parashtrime, për këtë arsye, vlerëson se ky akt duhet të përjashtohet nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës provuese në zgjidhjen e çështjes dhe të refuzohet të merret si provë, bazuar edhe në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

(iv) Lidhur me dy vërtetimet e pagave të subjektit të rivlerësimit, me nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pukë, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në funksionin e zëvendëskryetares së kësaj gjykate, të paraqitur me qëllim vërtetimin e të ardhurave të saj për periudhat 01.01.2014 – 31.12.2020 dhe 01.01.2003 – 28.02.2007, trupi gjykues konstaton se këto dokumente, ndonëse janë prodhuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, nuk rezultojnë të jenë administruar pranë tij. Në kushtet kur fakti që kërkohet të provohet, rezultojnë i evidentuar gjatë hetimit administrativ në Komision dhe i provuar përmes dokumentit vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 09.01.2016<sup>13</sup>, dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është paraqitur ndonjë argument apo arsye mbi pamundësinë e paraqitjes së tyre gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vlerëson se këto akte nuk mund të pranohen në cilësinë e provës, në këtë fazë të procesit, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, në një qëndrim garantist, edhe nëse ato do të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti i rivlerësimit kërkon të provojë, të ardhurat e pretenduara nga këto dokumente kanë vlera lehtësisht më të larta se ato të përcaktuara në vërtetimin e të ardhurave të së njëjtës periudhë, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, për një diferencë pozitive prej 127.987 lekësh.

24. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Në referencë të dispozitës së sipërcituar, trupi gjykues çmoi gjithashtu se debati gjyqësor në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit nuk është i nevojshëm dhe, se lidhur me këtë çështje, mund të arrihej në vendimmarrje nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion edhe për faktin se si më sipër evidentuar, aktet shkresore të

---

<sup>13</sup> Vërtetim “Mbi pagat e subjektit për periudhën 1998 – 2016”, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, bashkëngjitur deklaratës së pasurisë vetting në ILDKPKI.

dorëzuar në cilësinë e provave të reja, nuk përmbushën kriteret e pranueshmërisë si prova të reja në proces. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

*B. Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet e ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material*

***Në lidhje me “Shuma të kursyera deri në vitin 2015, dhënë prindërve”***

25. Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *subjekti ka bërë deklaram të pasaktë në lidhje me kursimet cash dhe gjendjen e tyre në fund të viteve përkatëse. Subjekti nuk ka deklaruar shumat e dhuruara prindërve dhe ndryshimet e gjendjes cash në DPV-të periodike. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke ngritur pretendimet që trajtohen në vijim:*
26. *Komisioni, në mënyrë të gabuar, i ka konsideruar gjendjet cash të krijuara ndër vite si kursime të të gjithë familjes, duke i përfshirë si të tilla edhe në analizën financiare. Sipas subjektit të rivlerësimit Komisioni ka keqpërdorur deklaramet e saj lidhur me kontributet e dhëna në familje prindërve, duke i konsideruar ato si dhurime, ndërkohë që ato nuk kanë qenë shuma të dhuruara për një qëllim të caktuar, por kanë qenë kontribute të vazhdueshme në familje (duke dorëzuar rrogën) në kushtet e një ekonomie të përbashkët.*
27. Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, bazuar në deklaramin e subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore, në përgjigje të pyetjes se çfarë përfaqësonin kursimet cash të deklaruara në deklaramat e interesave periodikë privatë për vitet 2004 – 2007, deklaroi se ato përfaqësonin kursimet e të gjithë familjes, ka vlerësuar që këto kursime, në ndryshim nga rezultatet e hetimit, në përfundim të hetimit administrativ, t’i përlllogarisë në analizën financiare të periudhës 1996 – 2007, si kursime të të gjithë familjes<sup>14</sup>.
28. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në raport me konkluzionin e Komisionit, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:
  - 28.1 Nga verifikimi i deklaramtës së pasurisë *vetting* dhe deklaramtave të interesave periodikë privatë (në vijim “DIPP”), të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, rezulton se:
    - (i) Në deklaramtën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Shumat e tjera të kursyera deri në vitin 2015, dhënë babait tim B. H. dhe nënës R. H.*”. Nuk deklarohet vlera e shumës së kursyer dhe pjesa takuese.
    - (ii) Në deklaramtën e personit që mbart detyrim për deklaram pasurie, të vitit 2003<sup>15</sup>, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Adresa e plotë e banimit: “*Lagjja ‘{\*\*\*}’, Pukë*”.

<sup>14</sup> Shih paragrafin 4.24 të vendimit të Komisionit.

<sup>15</sup> Kjo deklaramtë është dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 30.06.2004, dhe është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit në funksionin e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, e emëruar në detyrë më datë 09.05.1998.

- (iii) Në DIPP-në e vitit 2004, deklarohet: “Gjendje cash 600.000 lekë. Pjesa takuese 100%. Kursimet e vitit 2004”. Adresa e plotë e banimit: “Lagjja ‘{\*\*\*}’, Pukë”.
- (iv) Në DIPP-në e vitit 2005, deklarohet: “Shtuar në gjendjen cash të deklarimit të mëparshëm vlera 700.000 lekë. 1.300.000 lekë. Pjesa takuese 100%”. Adresa e plotë e banimit: “Lagjja ‘{\*\*\*}’, Pukë”.
- (v) Në DIPP-në e vitit 2006<sup>16</sup>, deklarohet: “Shtuar në pasurinë e deklaruar më parë shuma 600.000 gjendje cash lekë, kursyer nga paga e kryetares së Gjykatës së Rrethit Pukë. 600.000 lekë. 100%”.
- (vi) Në deklaratë e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar më datë 30.03.2007, në funksionin e inspektore në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje cash. Adresa e plotë e banimit: “Lagjja ‘{\*\*\*}’ e Rrethit Pukë”.
- (vii) Në DIPP-në e vitit 2007, deklarohet: “Shtuar në pasurinë e deklaruar më parë gjendje cash, kursyer nga paga e inspektore së KLD. 100.000 lekë”. Deklarimi në rubrikën e vendqëndrimit është i palexueshëm.
- (viii) Në DIPP-në e vitit 2008 nuk deklarohet gjendje cash, shtesë apo pakësim i saj. Në rubrikën e vendqëndrimit deklarohet: “Banoj në shtëpinë e prindërve me vëllain dhe motrën, në rrugën ‘{\*\*\*}’ (e pahipotekuar)”.
- (ix) Në DIPP-të e viteve 2009 – 2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje cash, shtim apo pakësim të saj. Në rubrikën e vendqëndrimit të këtyre deklaratave nuk deklarohet adresë me përjashtim të DIPP-së së vitit 2016, në të cilën deklarohet: “Lagjja ‘{\*\*\*}’, Pukë”.

**28.2** Me nisjen e hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, lidhur me adresat e banimit që nga momenti i marrjes së detyrës për herë të parë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, që nga marrja e detyrës në vitin 1998 e në vijimësi, ka bashkëjetuar me prindërit dhe familjarë të saj, duke përballuar shpenzimet në mënyrë të përbashkët. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: (i) në periudhën 1998 – 2007 ka banuar në adresën Lagjja “{\*\*\*}” Pukë, në pronësi të prindërve; (ii) në periudhën 2007 – 2008 ka banuar me babain B. H. dhe të motrën A. H., në apartamentin e marrë me qira, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë; (iii) në periudhën nëntor 2008 – dhjetor 2012 ka banuar në apartamentin e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, të blerë nga babai, B. H., me kontratë porosie; (iv) në periudhën dhjetor 2012 e në vazhdim ka banuar në lagjen “{\*\*\*}”, Pukë, banesë në pronësi të prindërve të saj. Në pyetësorin vijues me nr. 2, nisur nga fakti i mosdeklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting* të një vlere konkrete të *kursimeve cash të krijuara ndër vite të dhëna prindërve*, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë sqarime mbi vlerën, kohën e dhënies së tyre prindërve dhe, duke i konsideruar ato si dhurime të subjektit ndaj prindërve, ka kërkuar sqarime mbi arsyet e mosdeklarimit të tyre në deklaratat

<sup>16</sup> Deklaratë e plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, në funksionin e Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë.



e interesave periodikë privatë. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Nuk kam mbajtur shënime lidhur me gjendjen cash të kursyer ndër vite, përveç asaj të deklaruar në deklaratat periodike. Pas vitit 2005, gjendja cash është shuma e kursyer nga vitet paraardhëse dhe shumat që rezultojnë nga paga dhe të ardhurat e tjera që rezultojnë nga marrëdhënia e punës, që reflektohen edhe nga lëvizjet e bëra në llogarinë rrjedhëse. Pjesa më e madhe e këtyre kursimeve u është dhënë prindërve ndër vite, për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe shpenzime të tjera në formë kontributi familjar. Në këtë kontekst nuk ka qenë një dhurim në vlerën totale të vlerës cash të deklaruar në deklaratat periodike, por kontribute në vlera dhe periudha të ndryshme. [...] Gjendja cash e krijuar nga viti 2003 deri në vitin 2007, është shuma e kursyer nga paga dhe të ardhurat e tjera, që rezultojnë nga marrëdhënia e punës që reflektohen edhe nga lëvizjet e bëra në llogarinë rrjedhëse. [...] Pas vitit 2007, nuk kam patur gjendje cash në shtëpi, rrjedhimisht nuk kam shtim apo pakësim të gjendjes cash, por kam patur vetëm debitime të llogarisë së pagës për nevojat e jetesës sime dhe familjes”*. Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një pasqyrë në formë tabelore të të ardhurave të pretenduara nga paga dhe shpërblime, nga viti 2003 deri në vitin 2017, së bashku me balancën më 31 dhjetor të çdo viti, si dhe certifikatë familjare me nr. {\*\*\*}, lëshuar më datë 18.10.2021, nga Zyra e Gjendjes Civile Pukë, nga verifikimi i së cilës rezulton se subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha është ndarë nga trangu familjar më datë 10.08.1993.

**28.3** Nga informacioni i administruar në lidhje me pasuri të paluajtshme në pronësi të subjektit të rivlerësimit apo prindërve të saj, rezulton se: (i) AShK, Zyra Vendore Pukë<sup>17</sup>, ka konfirmuar të regjistruar në bashkëpronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit, B. H. dhe R. H., pasurinë me nr. {\*\*\*}, e llojit truall, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, nga e cila 117 m<sup>2</sup> ndërtesë, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Pukë, dhe pasuria me nr. {\*\*\*}, e llojit ndërtesë, me sipërfaqe 315 m<sup>2</sup>, ish-magazina e drithit, Pukë; (ii) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>18</sup>se apartamenti i ndodhur në Tiranë, në rrugën “{\*\*\*}”, që është i njëjti me atë të deklaruar në deklaratat periodike në rrugën “{\*\*\*}” (për shkak të sistemit të adresave), i blerë nga babai i saj, B. H., me kontratë porosie, është i peregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

**28.4** Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit<sup>19</sup>, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Dëshiroj të shpjegoj që unë kam bashkëjetuar me prindërit e mi për gjatë gjithë periudhës. Nisur nga statusi im shoqëror, beqare, lidhja ime me prindërit dhe familjen ka qenë shumë e ngushtë. Përgjatë gjithë periudhës, por edhe përpara detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë në vitin 2004, të ardhurat e mia kanë qenë të njësuara me ato të prindërve. Duke qenë një familje patriarkale dhe tradicionale, të ardhurat e mia janë dorëzuar kryesisht në familje, natyrisht duke përdorur nga këto të ardhura aq sa më nevojiteshin për shpenzime personale. Nisur nga fakti që të ardhurat nga paga dorëzoheshin në familje, duke mos u konceptuar si një dhuratë, por si një detyrim familjar, të ardhurat e mia janë përdorur për shpenzime*

<sup>17</sup> Shih shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 01.06.2020, nga AShK, Drejtoria Vendore Pukë.

<sup>18</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

<sup>19</sup> Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës lidhur me konkluzionet: 1. Në analizën financiare, kursimet cash janë vlerësuar sipas deklarimeve periodike të subjektit në deklaratat periodike për periudhën 2003 – 2016. 2. Duket se ka një mospërputhje mes deklarimit për kursimet cash në deklaratat periodike dhe në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti në deklaratën vetting, dhe në përgjigje të pyetësorëve. 3. Duket se subjekti ka bërë deklarin të pasaktë lidhur me kursimet cash dhe gjendjen e tyre në fund të viteve përkatëse. Subjekti nuk ka deklaruar shumat e dhuruara prindërve dhe ndryshimet cash në DPV periodike. 4. Për mundësinë financiare për krijimin e këtyre kursimeve cash për vitet 2004 – 2007, shih tabelën në analizën financiare. në pikën 8 të këtyre rezultateve të hetimit.

*familjare, por edhe për kursime të përdorura nga babai ynë. Në përgjigjet e mia në pyetësor, për këtë arsye, nuk kam mundur të saktësoj një shumë të saktë dhënë prindërve të mi. Në deklaratimet e mia përgjatë viteve 2004 – 2007, unë jam mundur të përlllogaris një shumë të kursyer nga të ardhurat gjatë vitit, por nuk kam evidentuar pakësimin e tyre nga përdorimi nga babai në investimet në bono thesari apo në llogaritë bankare. Shpjegoj që ky gabim, pasaktësi, përveç faktit të mostrajnitit apo njohurive të duhura për plotësimin e deklaratave për deklarimin e pasurisë, ka ardhur edhe për shkak të statusit tim social. Unë jam ndarë nga familja në zyrën e gjendjes civile që nga viti 1993, por realisht unë kam jetuar dhe vazhdoj të jetoj me prindërit. Në deklaratën e parë të deklarimit të pasurisë, por edhe në ato periodike, detyrimi për deklarim është i anëtarëve të familjes, të cilët janë në certifikatën e gjendjes civile, madje edhe nëse prindërit do të kishin qenë në certifikatën e gjendjes civile, nuk ka qenë i parashikuar detyrimi i tyre për deklarim të pasurisë. Ky detyrim parashikohej për fëmijët madhorë me pasuri veçmas, bashkëshorti/ja e më pas edhe bashkëjetuesja. Për këtë arsye, nga ana ime nuk janë evidentuar edhe ndryshimet në lidhje me cash-in. Duke mos mbajtur një evidencë të saktë, për shkak se të ardhurat dhe shpenzimet familjare ishin të përbashkëta (të miat dhe të prindërve), edhe deklaratimet e mia në vitet pas 2007, në mungesë të një shifre të saktë, nuk kam deklaruar në lidhje me gjendjen e cash-it [...]. Kujtoj që në deklaratën e parë të kryer në mars të vitit 2004, për arsye që shpjegova më lart, e ndarë nga trangu familjar dhe në certifikatën familjare jam vetëm unë, deklarimi im është jo i plotë duke mos evidentuar dhe saktësuar apo sqaruar që kursimet e mia janë të përbashkëta me ato të familjes [...].*

**28.5** Në seancën dëgjimore të datës 22.02.2022<sup>20</sup>, i pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar së çfarë përfaqësonin specifikisht kursimet *cash* të deklaruara në deklaratat e interesave privatë, për vitet 2004 – 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ato përfaqësonin kursime të të gjithë familjes.

**28.6** Bazuar në situatën e fakteve të përshkruar më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është shkëputur nga familja e origjinës që më datë 10.08.1993, pra përpara emërimit në detyrën e gjyqtarës më datë 09.05.1998, dhe rezulton me gjendje familjare më vete deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Nga kjo pikëpamje, prindërit e subjektit nuk gëzonin ndonjë status ligjor që detyronte subjektin e rivlerësimit si subjekt deklarues, apo ata vetë, që të bënin deklarime për kursimet e tyre. Përpos këtij informacioni që buron nga dokumentet ligjore, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, ndonëse ka mbajtur qëndrim kontradiktor mbi natyrën e gjendjes *cash* të deklaruar prej saj në deklaratat e interesave periodikë privatë, për vitet 2003 – 2007, duke i konsideruar herë si kursime personale, e herë si familjare, ka qenë konsistente në deklarimin e saj, se ajo ka jetuar në të njëjtën banesë me prindërit dhe familjarë të saj gjatë gjithë viteve, duke pasur një ekonomi të përbashkët me ta. Edhe pse nga leximi i deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratat e interesave periodikë privatë për vitet 2003 – 2007, nisur nga pjesa takuese e deklaruar në to, 100% në pronësi të subjektit të rivlerësimit, dhe burimi i krijimit të deklaruar nga pagat, ato përbëjnë kursime personale të saj, në situatën faktike të një jetese dhe ekonomie të përbashkët, ku gjithsecili nga anëtarët e familjes kontribuon për përballimin e shpenzimeve familjare, edhe kursimet konsiderohen të përbashkëta, pra familjare. Bazuar në këtë arsyetim, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit për t'i konsideruar kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave periodikë privatë, si

<sup>20</sup> Shih procesverbalin e seancës dëgjimore, faqja 23.

kursime familjare, e për t'i përlllogaritur si të tilla në analizën financiare. Në këto rrethana, nën një regjim me ekonomi të përbashkët familjare, me kontribute të vazhdueshme të anëtarëve të familjes, ku të ardhurat dhe shpenzimet konsiderohen të përbashkëta, nuk mund të flitet për shuma të dhuruara mes anëtarëve të familjes.

29. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se: *pasaktësitë në deklaratime kanë konsistuar vetëm në mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes cash në deklaratat e interesave periodikë privatë dhe në plotësimin e deklaratës fillestare, por jo në deklaratën e pasurisë vetting apo në pyetësorë, pasi në kushtet e një ekonomie të përbashkët ka qenë e vështirë të saktësohet kontributi i saj.* Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vëren se Komisioni, ndonëse ka arritur në konkluzionin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me shumën e dhuruara prindërve është i pasaktë, nuk i ka atribuuar atij ndonjë nga pasojat ligjore në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, për t'i dhënë përgjigje pretendimit të subjektit, trupi gjykues sjell në vëmendje se, në zbatim të përcaktimeve të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin për të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, të gjitha pasuritë që ata disponojnë në momentin e plotësimit të kësaj deklaratë dhe burimet e financimit të tyre. Në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim të deklarojë lidhur me shumën e kursyera të dhëna prindërve deri në vitin 2015 dhe se pasaktësitë në deklaratat e interesave periodikë privatë, si mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes *cash* në to, si detyrim ligjor në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi për pasaktësi të deklaratës së pasurisë *vetting* sipas ligjit nr. 84/2016. Megjithatë, në kushtet kur këto kursime deklarohen si kontributi i saj në blerjen pasurisë *apartament* në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, që trajtohet në vijim të këtij vendimi, ato do të bëhen objekt i kontrollit të analizës financiare mbi mundësinë e krijimit me burime të ligjshme të kësaj pasurie.

#### ***Apartment në përdorim në vitet 2008 – 2012, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë***

30. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: *“Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartment në rrugën “{\*\*\*}”, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në germet “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016”.*
31. Subjekti i rivlerësimit, duke e konsideruar këtë konkluzion si tërësisht të gabuar, tendencioz, të palogjikshëm, të pabazuar në prova e në fakte dhe në shtrembërim të situatës faktike e ligjore, pretendon se *nuk ka pasur detyrim ligjor për deklarimin e pasurisë së krijuar nga prindërit, pasi ajo është ndarë me gjendje civile prej tyre që në vitin 1993, megjithëse që pas përfundimit të studimeve të larta dhe nisjes së detyrës ka jetuar me ta duke ndihmuar në krijimin e të ardhurave për blerjen e saj, si pjesëtare e familjes.* Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentin se *ajo nuk ka të regjistruar ndonjë titull pronësie apo të drejtë reale mbi këtë pasuri dhe se porositës i saj është i ati, ndërsa kontributet e fëmijëve në krijimin e kësaj pasurie janë sikundër në çdo familje shqiptare, ku ekonomia e familjes mëkëmbet kur fëmijët bëhen madhorë dhe hyjnë në marrëdhënie pune duke krijuar*

*mundësi për të ndihmuar ekonominë e familjes. Në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë vetting, kjo pasuri nuk është konceptuar si një apartament në përdorim për shkak se në këtë periudhë ajo jetonte në shtëpinë e prindërve në lagjen “{\*\*\*}”, Pukë dhe se përdorimi nuk është i vazhdueshëm, siç ishte në periudhën 2008, megjithatë e ka deklaruar si adresë. Burimet e krijimit të kësaj pasurie janë detajuar gjatë procesit të rivlerësimit, ndërkohë që në familjen e saj nuk janë mbajtur llogari të veçanta mbi të ardhurat dhe shpenzimet e kryera nga secili anëtar i familjes apo kursimet e secilit për të gjykuar mbi pjesën takuese. Gjithashtu, sipas saj, Komisioni ka keqinterpretuar edhe konceptin e personit të lidhur duke sjellë si pasojë një analizë të gabuar të burimeve të ligjshme të pasurisë. Fakti që ky apartament është deklaruar si adresë banimi në deklaratimet periodike të vitit 2008-2013<sup>21</sup> (fillimisht rruga “{\*\*\*}”, e cila ka ndryshuar më pas në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë) tregon në mënyrë shteruese, të qartë e përfundimtare se ajo në asnjë moment nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij apartamenti dhe se një fakt që dëshmon se kjo pasuri është në emër të babait të saj janë edhe librezat e ujit dhe dritave, të cilat janë lidhur në emër të tij.*

32. Nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni konkluzionin e tij se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, duke i atribuar pasojën ligjore të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me fshehjen e pasurisë, e ka mbështetur në argumentet si vijojnë: (i) subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e këtij apartamenti dhe burimet e krijimit në deklaratën vetting; (ii) subjekti gjatë hetimit, nuk ka deklaruar qartë burimin e krijimit të këtij apartamenti duke mos përcaktuar pjesën e saj takuese në vlerë monetare; (iii) ka marrëdhënie të pandërprerë me përdorimin e këtij apartamenti që nga momenti i blerjes, kohë kur subjekti ka ushtruar detyrën e inspektores në KLD; (iv) prindërit jetojnë në Pukë dhe e përdorin vetëm në rastet kur vijnë bashkë me subjektin në Tiranë; (v) subjekti nuk përcaktoi qartë kontributin saj në këtë pasuri; (vi) subjekti dhe familja e saj kanë mungesë të burimeve të ligjshme në shumën 5.257.890 lekë; (vii) subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime për vendosjen e apartamentit në emër të babait të saj, si person i cili nuk ishte i lidhur me subjektin (pasi nga gjendja civile vërtetohet se subjekti nuk është në certifikatë me babain) dhe, si i tillë, nuk është i detyruar të deklarojë pasurinë me qëllim fshehjen e kësaj pasurie, si person jo i lidhur me të duke mos qenë në të njëjtën certifikatë familjare; (viii) mosdeklarimi i përdorimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë vetting, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, është bërë me qëllimin e vetëm për t’u mos evidentuar dhe deklaruar në ILDKPKI, sepse kjo pasuri është krijuar nga burime të paligjshme nga subjekti dhe personat e tjerë të lidhur, sipas pikës 14, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. Në të kundërt, subjekti, nëse ishte nga burime të ligjshme do të duhet ta kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting.
33. Në funksion të shqyrtimit të shkakut të ankimit, në raport me konkluzionin e mësipërm, trupi gjykues mori në analizë aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri, me qëllim për të evidentuar në mënyrë të saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me të, në drejtim të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim, nga ku konstatoi situatën faktike si vijon:

### 33.1 Nga analizimi i deklaratës së pasurisë vetting dhe deklaratave të interesave periodikë privatë të

<sup>21</sup> Subjekti referon konkretisht DIPP-në e vitit 2008, në të cilën deklarohet se: “Banoj në shtëpinë e prindërve me vëllain dhe motrën, në rrugën “{\*\*\*}” e pahipotekuar”.

dorëzuar pranë ILDKPKI-së, ndër vite, rezulton se: (i) në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri të paluajtshme në pronësi apo në përdorim, ndërsa në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në gjendjen civile” deklarohet adresa *Lagjja “{\*\*\*}”, Pukë*. Në rubrikën “Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni”, të po kësaj deklarate, nuk deklarohet adresë; (ii) në DIPP-të për vitet 2003 – 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë vendbanimi adresën *Lagjja “{\*\*\*}” Pukë*; (iii) në DIPP-në e vitit 2007 shënimi në rubrikën “Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni” është i palexueshëm; (iv) në DIPP-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar “*Banoj në shtëpinë e prindërve me vëllain dhe motrën në rrugën “{\*\*\*}” (e pahirpotekuar)*”; (v) në DIPP-të për vitet 2009 – 2015, rubrikat respektive mbi adresën e vendbanimit nuk rezultojnë të plotësuara; (vi) në DIPP-në e vitit 2016 e në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë vendbanimi adresën *Lagjja “{\*\*\*}”, Bashkia Pukë*.

**33.2** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard të Komisionit, lidhur me adresat e banimit që nga momenti i marrjes së detyrës, subjekti ka deklaruar, ndër të tjera<sup>22</sup>, se në periudhën *nëntor 2008 – dhjetor 2012* ka banuar në adresën “*Rr. {\*\*\*}, Nd.{\*\*\*}, Hyrja {\*\*\*}, Ap.{\*\*\*}, Tiranë, blerë nga babai B. H. me kontratë porosie*”, duke bashkëjetuar në të me prindërit dhe motrën e saj. Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa akte shkresore, nga verifikimi i të cilave rezulton se: (i) me kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.09.2007, të lidhur ndërmjet babait të subjektit të rivlerësimit, z. B. H., në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK<sup>23</sup> në cilësinë e sipërmarrësit, palët kanë rënë dakord për ndërtimin e një apartamenti në godinën e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe 90,36 m<sup>2</sup>, me vlerë 63.250 euro, që do të likuidohet si vijon: *kësti i parë* prej 28.070 eurosh është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale dhe nuk ka pretendime për to; *kësti i dytë* prej 35.180 eurosh do të likuidohet brenda datës 20.12.2007 dhe do t’i dorëzohet palës porositëse me një procesverbal të rregullt për marrjen e pronës në dorëzim të firmosur nga të dyja palët. Në kontratë përcaktohet se kalimi i pronësisë së apartamentit do të bëhet përmes një kontrate të veçantë, pas pagesës së këstit të fundit të çmimit dhe pasi të jetë përfunduar ndërtimi i krejt ndërtesës; (ii) sipas certifikatë familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Pukë, në datën 19.02.2020, subjekti i rivlerësimit Flutura Hoxha në regjistrin e gjendjes civile rezulton kryefamiljar i vetëm.

**33.3** Në pyetësorin vijues me nr. 2, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime mbi mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* të apartamentit të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, si pasuri në përdorim, kontributin e saj në blerjen e kësaj pasurie, si dhe pronarin e pasurisë, duke i kërkuar të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë, si dhe të paraqesë kontratën e shitblerjes së bashku me dokumentacionin mbi regjistrimin e saj pranë regjistrit të pasurive të paluajtshme. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se apartamenti me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, i deklaruar në përdorim në deklaratat periodike, është i njëjti apartament me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, i deklaruar në pyetësorin standard, i cili është porositur nga babai B. H. me kontratën e porosisë nr. {\*\*\*} rep., datë

---

<sup>22</sup> Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe dy adresa të tjera banimi në periudhat si vijojnë: (i) në periudhën 1998 – 2007 dhe dhjetor 2012 – e në vazhdim, ka banuar në adresën lagjja “{\*\*\*}”, Pukë, në pronësi të prindërve; (ii) në periudhën 2007 – 2008 ka banuar në adresën rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, marrë me qira me motrën A. H. dhe babain B. H., pa dokumentacion provues.

<sup>23</sup> Përfaqësuar nga administratori i shoqërisë B. Xh. dhe nga ortakët V. B. dhe P. M.

17.09.2007 dhe se akoma nuk është bërë regjistrimi pranë regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Si burim krijimi për këstin e parë në shumën 28.070 euro, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet ndër vite të prindërve B. dhe R. Hoxha, të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat, kontributet e vëllait S. H. dhe motrës A. H., kontributi i vetë subjektit të rivlerësimit nga të ardhurat e pagës, si dhe shuma prej 1.000.000 lekësh e marrë hua nga babai i saj te miku i tij R. M. Ndërsa për këstin e dytë në vlerën 35.180 euro si burim krijimi kanë shërbyer bono thesari në vlerën 1.600.000 lekë në emër të vëllait S. H., si dhe dy bono thesari përkatësisht në shumat 500.000 lekë dhe 3.130.000 lekë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. B. H.

**33.4** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur sqarimeve të mësipërme, rezulton se: (i) sipas mandatarkëtim nr. {\*\*\*}, datë 17.09.2007, me vulë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, është likuiduar shuma prej 28.070 eurosh nga z. B. H., për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrim: “*Kësti i parë: Ap. Nr. {\*\*\*}, K. {\*\*\*}, sip. 90,36 m<sup>2</sup>*”; (ii) sipas dokumentit “Kërkesë për transfertë fondesh” të “Raiffeisen Bank” ShA, të datës 26.12.2007, është transferuar shuma prej 4.220.000 lekësh nga S. H. te P. M. (ortak i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK), me përshkrim “*Likuidim kësti kredie*”; (iii) nëpërmjet urdhrorit të transfertës së Bankës së Shqipërisë më datë 24.12.2007, është transferuar në llogarinë e z. S. H. në “Raiffeisen Bank” ShA vlera e bonos në shumën 1.588.514 lekë; (iv) nëpërmjet urdhrorit të transfertës së Bankës së Shqipërisë më datë 24.12.2007, është transferuar në llogarinë e z. S. H., në “Raiffeisen Bank” ShA, vlera e bonos në shumën 3.604.033 lekë.

**33.5** Në vijim të hetimit administrativ, kërkesës së Komisionit për të dhënë sqarime mbi kontributin konkret nga secili pjesëtar i familjes për blerjen e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur me sqarimin e dhënë në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, se kontributi i saj në këtë pasuri është vlera *cash* e deklaruar në deklaratat periodike që është kursyer nga paga dhe të ardhurat e tjera nga marrëdhënia e punës, në bazë të vlerave të tërhequra nga llogaria rrjedhëse, si dhe të ardhurat e prindërve, motrës dhe vëllait të saj. Veç këtyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka kontribuar edhe për blerjen e pajisjeve elektroshtëpiake të këtij apartamenti në periudhën 2008 – 2009. Në mbështetje të pretendimeve të tij në lidhje me burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një sërë aktesh shkresore<sup>24</sup>.

**33.6** Nga informacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së dhe ai i përcjellë në Komision nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>25</sup> Tiranë, nuk rezultuan të dhëna mbi regjistrimin e kësaj pasurie të paluajtshme në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të saj B. H. e R. H.

**33.7** Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Furnizuesi i Shërbimit Universal<sup>26</sup> ShA, rezulton se me gjeneralitetet e plota të subjektit të rivlerësimit Flutura B. Hoxha dhe babait të saj B. E. H. nuk

<sup>24</sup> Deklaratë e babait të subjektit të rivlerësimit, z. B. H., datë 24.11.2021, mbi punimet topografike të kryera dhe të ardhurat e siguruar për periudhën 1998 – 2007; vërtetim nr. {\*\*\*}, datë 23.11.2021, për trajtim me pension pleqërie të B. H.; vërtetim nr. {\*\*\*}, datë 22.11.2021, për trajtim si invalid pune të B. H.; vendimi datë 22.10.1999, i Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë, për dhënie dëmshpërblimi nga aksidenti automobilistik, z. B. H.; kërkesë nr. {\*\*\*} prot., datë 23.05.2006, drejtuar Ambasadës së Republikës së Kroacisë, për pajisje me vizë të shtetasve Flutura Hoxha, H. S., R. Gj. dhe O. F.; shkresë nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2006, e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar KLD-së; shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 17.05.2006, e KLD-së drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; certifikatë vdekje e z. R. M.

<sup>25</sup> Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 04.06.2020, nga AShK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug dhe përgjigje me e-mail, e datës 17.04.2019, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>26</sup> Ky informacion është përcjellë në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.05.2020.

rezultojnë abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike. Ndërsa me gjeneralitetet e tyre me emër dhe mbiemër<sup>27</sup> rezultojnë disa kontrata furnizimi me energji elektrike në qytetin e Tiranës në adresa të ndryshme, një ndër të cilat në emër të z. B. H. i përket një adrese në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, por pa mundur të identifikohet nëse i përket pasurisë objekt shqyrtimi apo babait të subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, sipas informacionit të përcjellë në Komision nga “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë” ShA, nuk rezultojnë të dhëna për kontrata për shërbime ujësjiellës-kanalizime për subjektin e rivlerësimit dhe prindërit e saj.

**33.8** Veç sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime edhe në lidhje me një tjetër pasuri të llojit apartament me adresë {\*\*\*} nr. {\*\*\*}, apartament nr. {\*\*\*}, në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe 62,6 m<sup>2</sup>, në emër të babai të subjektit të rivlerësimit, z. B. H. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar<sup>28</sup> se ky apartament është blerë nga babai i saj B. H. në vitin 2017 në vlerën 37.500 euro, me burim kursimet nga të ardhurat nga puna, pensioni i pleqërisë dhe invaliditetit të tij, të ardhurat nga paga dhe pensioni i nënës, të ardhurat nga pagat e vëllait dhe motrës. Ky apartament i është dhuruar fëmijëve të vëllait S. H., me kontratë dhurimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.12.2021, të cilën e ka paraqitur bashkëlidhur përgjigjeve të saj<sup>29</sup>.

**33.9** Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i njoftoi subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, barrën e provës: “*Duket se, subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të paplotë në lidhje me këtë pasuri, duke u përpjekur ta fshehtë atë si dhe burimin e krijimit*”. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim se ky apartament është porositur nga babai i saj B. H. përmes kontratës së porosisë të sipërcituar dhe se për krijimin e saj kanë investuar të gjithë anëtarët e familjes. Ndërsa në seancën dëgjimore të datës 22.02.2022, i pyetur nga anëtarët e trupit gjykues mbi përdorimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se në këtë apartament ka banuar së bashku me prindërit dhe familjarët e saj në periudhën që ajo është transferua me punë në qytetin e Tiranës.

**34.** Në analizë të situatës së fakteve të pasurisë apartament me sipërfaqe 90,36 m<sup>2</sup>, rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, përshkruar më sipër rezulton se:

(i) kontrata e porosisë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.09.2007, për ndërtimin e apartamentit është lidhur me shoqërinë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. B. H. dhe pagesat për këtë shoqëri janë kryer prej tij dhe vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. S. H., përkatësisht në datat 17.09.2007 dhe 19.12.2007;

---

<sup>27</sup> Sipas informacionit të përcjellë nga FSHU-ja, me gjeneralitetet Flutura B. Hoxha, nuk rezulton abonent me kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike ShA. Me gjeneralitetet Flutura Hoxha identifikohen 6 (gjashhtë) abonentë me kontratë furnizimi me energji elektrike. Referuar formularëve të detajeve mbi abonentin të këtyre kontratave rezultojnë që ato të jenë të lidhura 1 (një) në Elbasan, 1 (një) në Durrës dhe 4 (katër) në Tiranë, nënstationi {\*\*\*}. Me gjeneralitetet B. E. H. rezulton një abonent me kontratë të furnizimit me energji në Shkodër. Ndërsa me gjeneralitetet B. H. identifikohen 13 abonentë, nga të cilët 3 (tre) abonentë në Tiranë, përkatësisht në adresat {\*\*\*}, {\*\*\*}, {\*\*\*}. R. M. H. nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

<sup>28</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

<sup>29</sup> Nga informacioni i përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug, në lidhje me këtë apartament është emetuar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit leja e legalizimit me nr. {\*\*\*}, datë 16.05.2019.

(ii) megjithëse çmimi i blerjes është likuiduar plotësisht që më datë 19.12.2007, nuk rezulton të jetë lidhur kontrata përfundimtare e shitblerjes dhe pasuria nuk është regjistruar ende në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për pasojë nuk ka një titull pronësie;

(iii) subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar bashkëjetesën e vazhdueshme me prindërit dhe familjarët e saj nën regjimin e një ekonomie të përbashkët familjare, që nga nisja e ushtrimit të detyrës si gjyqtare në vitin 1998, megjithëse në regjistrat e gjendjes civile rezulton e shkëputur nga familja e origjinës që nga viti 1993;

(iv) në deklaratën e interesave periodikë privatë për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit në rubrikën e vendbanimit ka deklaruar *banoj në shtëpinë e prindërve me vëllain dhe motrën në rrugën “{\*\*\*}”* (e pahipotekuar);

(v) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar në këtë apartament në periudhën 2008-2012, gjatë ushtrimit të detyrës si inspektore pranë ish-KLD-së, ndërkohë që pas kësaj periudhe, me kthimin në qytetin e Pukës, vijon ta përdorë kur vjen në Tiranë ose gjatë fundjavave;

(vi) në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri në pronësi apo në përdorim. Në këtë deklaratë deklarohet ai adresë e regjistrimit në gjendjen civile adresa *lagjja “{\*\*\*}”*, Pukë, ndërsa në rubrikën nëse disponohet vendqëndrim tjetër nuk deklarohet adresë;

(vii) si burim për krijimin e kësaj pasurie ka shërbyer kontributi i të gjithë anëtarëve të familjes Hoxha.

35. Bazuar në sa më sipër, ndonëse subjekti i rivlerësimit në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* nuk ka gëzuar të drejta pronësie mbi këtë apartament, trupi gjykues vlerëson se referuar në nenet 30 e 31 të ligjit nr. 84/2016 dhe shtojcën nr. 2 të tij, ajo ka pasur detyrimin për të deklaruar marrëdhënien e interesit me këtë pasuri, si kontribuuese në krijimin të saj. Gjithashtu, në kushtet e një bashkëjetese dhe ekonomie të përbashkët familjare të pohuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, vlerësohet i pakuptimtë edhe argumenti mbi mungesën e vazhdueshmërisë së përdorimit të kësaj pasurie në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, ndërkohë që përkundër sa pretendohet në ankim adresa e kësaj pasurie nuk rezulton të jetë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, as si adresë vendqëndrimi tjetër. Sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, që kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike të lidhura në emër të babait të subjektit të rivlerësimit provojnë se kjo pasuri është në emër të tij, megjithëse ajo nuk ka depozituar dokumentacion për të mbështetur këtë pretendim, një fakt i tillë edhe nëse do të rezultonte i vërtetë nuk do të mund të justifikonte mosdeklarimin e pasurisë objekt shqyrtimi në deklaratën e pasurisë *vetting*.
36. Trupi gjykues e gjen me vend të nënvizojë në këtë rast natyrën dhe objektin e detyrimit për të provuar burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie, si jo të autorizuar drejtpërdrejt nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili ngarkon me këtë detyrim subjektet e rivlerësimit kur ato vetë deklarojnë se si burim i krijimit të pasurive të tyre kanë shërbyer shumat e dhëna hua apo dhuruar prej personave të tjerë të lidhur sipas kësaj dispozite, por i autorizuar nga nenet 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, që autorizojnë organet e rivlerësimit të hetojnë në drejtim të verifikimit të dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.
37. Në rastin konkret, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se ekzistojnë disa fakte të konstatuara që ngrenë dyshimin për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, të tilla si:



(i) mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* i marrëdhënies së interesit të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, si kontribuuese në krijimin e saj dhe si pasuri në përdorim në mënyrë të vazhdueshme në kushtet e bashkëjetesës me prindërit e jo vetëm për një periudhë kohore 4-vjeçare (2008 – 2012); (ii) mungesa e lidhjes së kontratës përfundimtare të shitblerjes dhe e kalimit të titullit të pronësisë së këtij apartamenti në emër të babait, megjithëse në kontratën e porosisë parashikohej që ky veprim juridik do të kryhej me likuidimin total të çmimit të shitjes dhe marrjen në dorëzim të apartamentit, veprime të cilat kanë përfunduar brenda vitit 2007; (iii) mosdeklarimi si adresë banimi e subjektit të rivlerësimit i adresës së këtij apartamenti në deklaratat e interesave privatë të viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012, përveç asaj të vitit 2008, ndërkohë që deklarimi në DIPP-në e vitit 2007 mbetet i paqartë; (iv) mosdeklarimi në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007, e cila përfaqëson deklarimin më të afërt në aspektin kohor, lidhur me momentin kur është krijuar pasuria objekt shqyrtimi, të kontributit të saj në krijimin e kësaj pasurie në formën e pakësimit të gjendjes *cash* për blerjen e kësaj pasurie; (v) blerja e një tjetër apartamenti në Tiranë në vitin 2017 nga babai i subjektit të rivlerësimit me kontributin e të gjithëve, por jo atë të subjektit të rivlerësimit, regjistrimi i saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të prindërve dhe dhurimi i saj në datën 08.12.2021 fëmijëve të vëllait të subjektit të rivlerësimit.

38. Me qëllim për të legjitimuar ekzistencën e dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi të verifikojë konkluzionin e Komisionit mbi mungesën e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në rrugën “{\*\*\*}”, bazuar në shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.
39. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *në analizën financiare nuk është përfshirë shuma e rezultuar në fund të vitit 2002, që përbën kursimet e gjithë familjes në vlerën 2.235.381 përfshirë dhe kontributin e subjektit të rivlerësimit, shumë e cila ishte pasqyruar si gjendje pozitive në fund të vitit 2002 që në rezultatet e hetimit. Sipas subjektit të rivlerësimit nuk ka logjikë ekonomike të ndërtohet analizën financiare të një pasurie të krijuar nga prindërit edhe pse me kontributin e subjektit të rivlerësimit, duke u bazuar në deklaratat periodike, për më tepër që Kolegji ka qëndrim të konsoliduar në kryerjen e analizës financiare të personave të lidhur apo të tjerë të lidhur, e cila bëhet kumulative për çdo vit, në ndryshim nga ajo subjektit të rivlerësimit që kushtëzohet nga deklaratimet periodike.*
40. Nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se Komisioni shprehet si vijon: “4.23. [...] nga Komisioni kjo vlerë (2.235.381 lekë) e pretenduar nga subjekti nuk mund të konsiderohet si gjendje në fund të vitit 2003 për shkak të mosdeklarimit të kursimeve *cash* në deklaratën e atij viti. Si rrjedhim, kjo vlerë nuk u konsiderua si burim për krijimin e depozitave dhe llogarive të tjera në vitet 2004 - 2005, nga babai i subjektit. 4.24. Subjekti në seancën dëgjimore, u pyet se çfarë përfaqësonin kursimet *cash* të deklaruara në vitet 2004 – 2007 dhe, në përgjigjen e saj, deklaroi se ato përfaqësonin kursimet e të gjithë familjes. Bazuar në këtë deklaratë të subjektit, në analizën financiare të periudhës 1996 – 2007, Komisioni përlllogariti kursimet e deklaruara në DPV si kursime të të gjithë familjes. Si rrjedhim, ndryshe nga rezultatet e hetimit, rezultati total i analizës së mundësisë së blerjes së apartamentit mbledh vetëm rezultatet negative të këtyre viteve dhe jo më rezultatet pozitive. Kjo për faktin se Komisioni vlerësoi se rezultatet e viteve pozitive nuk mund të mbarten si kursime tek viti pasardhës përderisa nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit”.

41. Duke përdorur konkluzionin e arritur nga trupi gjykues në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, sipas së cilit kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave periodikë privatë, në situatën faktike të një ekonomie të përbashkët familjare që prej vitit 1998, përbëjnë kursime familjare të subjektit të rivlerësimit dhe jo personale të tij, trupi gjykues vlerëson se Komisioni me të drejtë kursimet e akumuluarra deri në fund të vitit 2002, në vlerën 2.235.381 lekë, i ka konsideruar si gjendje *cash* deri në fund të vitit 2003, por për shkak të mosdeklarimit të ndonjë gjendjeje *cash* në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, shumat e akumuluarra deri në fund të vitit 2003 nuk janë përfshirë si kursime në analizë për vitet e mëpasshme, për krijimin e depozitave në vitet 2004 dhe 2005. Trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret analiza financiare nuk mund të shtrihet në drejtim të verifikimit të mundësisë financiare të familjarëve të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që kursimet e tyre janë përfshirë në analizën financiare, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Ky vlerësim konsiderohet se përmbush kriteret e një vlerësimi të arsyeshëm e objektiv në rrethanën faktike të një ekonomie të përbashkët të subjektit të rivlerësimit me familjarët e saj.
42. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit, investuar nga babai B. H. dhe vëllai S. H., në total në vlerën 724.953 lekë, nga e cila 473.312 lekë babai dhe 251.641 lekë vëllai referuar dokumentacionit nga Banka e Shqipërisë.*
43. Nga kontrolli i vendimit objekt ankimi, trupi gjykues vëren se kjo shumë nuk është përlllogaritur nga Komisioni në mesin e burimeve të ligjshme<sup>30</sup>, me arsyetimin se nga analiza e kryer nuk u vërtetua mundësia financiare për krijimin të bonove të thesarit në vitin 2005, nga babai B. H. në vlerën 3.630.000 lekë dhe nga i vëllai S. H. në vlerën 1.600.000 lekë, ndaj as të ardhurat e gjeneruara nga bonot e thesarit nuk u konsideruan si burim i ligjshëm për blerjen e një pasurie tjetër. Këtë konkluzion, Komisioni e ka lidhur me faktin që gjendja *cash* e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në fund të vitit 2002 në vlerën 2.235.381 lekë, e cila ka shërbyer si burim për investimet e babait të subjektit të rivlerësimit në depozitat e krijuara në vitet 2004 dhe 2005, për shkak të mosdeklarimit të saj në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, nuk u konsiderua si gjendje në fund të vitit 2003 e, për pasojë, nuk mund të jetë burim për krijimin e depozitave dhe llogarive të tjera në vitet 2004 – 2005.
44. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në lidhje me bonot e thesarit në emër të babait dhe të vëllait, trupi gjykues konstaton se:
- 44.1 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë *apartment në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë* dhe pagesat e kryera, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se si burim krijimi për likuidimin e këstit të dytë të apartamentit në vlerën 35.180 euro kanë shërbyer tre bono thesari, si vijojnë: (i) bono thesari në vlerën 1.600.000 lekë, e thyer në datën 19.12.2007, nga ku 11.486 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera *neto* 1.588.514 lekë është transferuar nëpërmjet urdhrit të transfertës së Bankës së Shqipërisë më datë 24.12.2007, në llogarinë rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në emër të vëllait S. H.; (ii) bono thesari në vlerën 500.000 lekë, e thyer në datën 21.11.2007, nga ku 3.498 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera *neto* e bonos është 496.502 lekë; (iii) bono thesari në vlerën 3.130.000 lekë, e thyer në datën 19.12.2007,

<sup>30</sup> Shih paragrafin 4.25 të vendimit të Komisionit.

nga ku 22.469 lekë është mbajtur tatim në maturim dhe vlera *neto* e bonos së bashku me vlerën 496.502 lekë të bono thesarit cituar më lart, në total 3.604.033 lekë, është transferuar nëpërmjet urdhrimit të transfertës së Bankës së Shqipërisë më datë 24.12.2007, në llogarinë rrjedhëse pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në emër të vëllait S. H. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, totali i bonove të thesarit është në vlerën 5.192.547 lekë, me të cilat është kryer pagesa e këstit të dytë të apartamentit në shumën 4.220.000 lekë ose 35.180 euro, kurse shuma prej 1.000.000 lekësh është përdorur për të shlyer huan e marrë ndaj të ndjerit R. M.

**44.2** Në pyetësoin vijues me nr. 3, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë sqarime dhe të vërtetojë burimin e ligjshëm të krijimit të bonove të thesarit. Në përgjigjet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se [...] *si burim për krijimin e bonove të thesarit janë kursimet ndër vite të prindërve B. dhe R. H., të ardhurat nga puna e babait në sektorin privat si topograf, si dhe kontributi nga të ardhurat e pagës time, të ardhurat e pagës së vëllait, të ndjerit S. H. dhe pagës së motrës, A. H. [...] Në vitin 2005, babai, B. H. ka investuar në bono thesari, në Bankën e Shqipërisë, vlerën 3.630.000 lekë, ndërsa vëllai, i ndjeri S. H. vlerën 1.940.000 lekë. Në total, vlera e investuar në Bono Thesari, është 5.570.000 lekë. Kjo vlerë ka si burim: kursimet në cash, në vlerën 1.300.000 lekë, të deklaruara në deklaratat periodike deri në vitin 2005, të kontribuar në familje; të ardhurat nga paga ime, sipas vlerave të tërhequra nga llogaria rrjedhëse në vitin 2005; të ardhurat e babait, B. H.; të ardhurat nga paga si mësuese të nënës, R. H.; të ardhurat si punonjës policie të vëllait S. H., si dhe vlera 250.000 lekë është kontribuar nga të ardhurat si ushtarake të motrës, A. H. [...]. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, sikurse në pyetësorët e mëparshëm, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se [...] investimet e bëra nga babai, B. H., në Bankën e Shqipërisë janë krijuar nga kursimet ndër vite nga paga dhe pensionet e prindërve B. dhe R. H., nga të ardhurat e krijuara nga puna e babait në sektorin privat, nga interesat bankare, si dhe kontributi nga të ardhurat nga paga ime, kontributi nga paga i vëllait, të ndjerit S. H. dhe kontributi nga të ardhurat nga paga të motrës, A. H. Sipas shpjegimeve të babait, një pjesë e derdhjeve/depozitave të mësipërme janë krijuar si rezultat i lëvizjeve bankare për shkak të interesave.*

**44.3** Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të Komisioni, duke deklaruar se kjo analizë nuk merr në konsideratë gjendjen e likuiditeteve *cash* të disponuar nga familjarët e saj, konkretisht babait, gjendje kjo që ka shërbyer për depozitimet dhe investimet në bono thesari, e cila në fund të vitit 2002 ka qenë në vlerën 2.235.381 lekë.

**44.4** Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe atij të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ në lidhje me bonot e thesarit, konstatohen dokumentet:

- i) kërkesë për transfertë fondesh në “Raiffeisen Bank” ShA, dega Lezhë, të datës 26.12.2007, në shumën 4.220.000 lekë, me përshkrim: “*Likuidim kësti kredie*”, nga urdhëruesi S. H. te përfituesi P. M.;
- ii) urdhër transfertë<sup>31</sup> nga llogaria {\*\*\*} e S. H. pranë Bankës së Shqipërisë në llogarinë e tij personale pranë “Raiffeisen Bank” ShA, shuma 1.588.514 lekë, me përshkrimin: “*Transfertë e vlerës së maturuar*”;

<sup>31</sup> Lëshuar nga Banka e Shqipërisë, zyra e sportelit të bonove të thesarit, datë 24.12.2007.

iii) urdhër transfertë<sup>32</sup> nga llogaria {\*\*\*} e B. H. pranë Bankës së Shqipërisë në llogarinë e S. H. pranë “Raiffeisen Bank” ShA, shuma 3.604.033 lekë, me përshkrimin: “*Transfertë e vlerës së maturuar*”;

iv) dokumenti <sup>33</sup>“kartela e klientit”, “form no. {\*\*\*}”, klienti: S. H.; tipi i veprimit “*sa kthyer vlera nominale në maturim*”, shuma e maturuar 1.588.514 lekë. Periudha: 21.12.2007-21.12.2007. Nuk ka datë të transaksionit;

v) dokumenti <sup>34</sup>“kartela e klientit”, “form no. {\*\*\*}”, klienti: B. H.; tipi i veprimit “*sa kthyer vlera nominale në maturim*”; shuma e maturuar 3.626.502 lekë. Periudha: 21.12.2007-21.12.2007. Nuk ka datë të transaksionit;

vi) nxjerrje nga llogaria nr. {\*\*\*}, e B. H., në Bankën e Shqipërisë, datë 22.11.2007, në të cilën evidentohet veprimi “*Vlera nominale në maturim*”, në shumën 500.000 lekë, tatim në maturim në vlerën 3.498 lekë;

vii) Banka e Shqipërisë<sup>35</sup> ka informuar Komisionin se B. H. ka hapur pranë saj llogari *cash* për blerjen e bonove të thesarit të shtetit shqiptar. Nga informacioni mbi gjendjen e klientit bashkëlidhur kësaj shkrese evidentohen bonot e thesarit në vlerat 500.000 lekë dhe 3.130.000 lekë investuar përkatësisht në datat 11.10.2005 dhe 20.12.2005, data e maturimit dhe interesat e përfituara.

45. Bazuar në situatën e fakteve të mësipërme, në lidhje me bono thesari në emër të vëllait të subjektit të rivlerësimit, nga analiza e dokumentacionit të sipërcituar, trupi gjykues konstaton se në datën e maturimit, më 24.12.2007, S. H. ka disponuar vlerën 1.588.514 lekë nga investimi në bono thesari, por pa mundur të përcaktohet koha e krijimit/investimit, shumat e depozituara, si dhe fakti se nga kush janë depozituar shumat fillestare. Dokumenti “*Kartelë e klientit {\*\*\*} S. H.*” (printim nga sistemi), me datë printimi 19.12.2007, në të cilin evidentohet shuma e maturuar në vlerën 1.588.514 lekë, nuk përmban të dhëna identifikuese të institucionit që e ka prodhuar atë dhe, si i tillë, informacioni që rezulton nga përmbajtja e tij nuk mund të konsiderohet si i provuar. Megjithatë, edhe në rast se ky dokument do të konsiderohej me vlerë të plotë provuese në drejtim të shumës, në mungesë të dokumentacionit provues mbi burimin e krijimit të kësaj shume, trupi gjykues në linjë me Komisionin vlerëson se edhe interesat e përfituara prej saj nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.

46. Sa i takon bonove të thesarit në shumat 500.000 lekë dhe 3.130.000 lekë, investuar përmes arkëtimeve *cash*, përkatësisht në datat 11.10.2005 dhe 20.12.2005, nga babai i subjektit të rivlerësimit B. H., duke u përfituar dhe interesat përkatës prej tij, nga verifikimi i informacionit bankar të administruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se: (i) Për bonot e thesarit në shumën 500.000 lekë, datë 11.10.2005, rezulton se deri në datën e investimit të kësaj shume ka vetëm një tërheqje nga llogaritë bankare të B. H., në shumën 1.391.122 lekë në datën 01.09.2005, e cila duket se është arkëtuar në datën 05.09.2009 në shumën 2.786.122, shumë kjo e tërhequr *cash* në datën 07.12.2005, së bashku me interesat e përfituar në vlerën 2.800.500 lekë. Ky fakt e bën të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se investimi

<sup>32</sup> Lëshuar nga Banka e Shqipërisë, zyra e sportelit të bonove të thesarit, datë 24.12.2007.

<sup>33</sup> Dokumenti nuk rezulton i nënshkruar dhe nuk ka vulë të institucionit.

<sup>34</sup> Dokumenti nuk rezulton i nënshkruar dhe nuk ka vulë të institucionit.

<sup>35</sup> Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020, e Bankës së Shqipërisë drejtuar Komisionit.

në bono thesari në shumën 500.000 lekë në datën 11.10.2005, ka si burim kalimin nga depozitat e babait, pasi ky investim nuk mund të ketë si burim shumat e tërhequra në dhjetor të vitit 2005; (ii) Për bonot e thesarit në shumën 3.130.000 lekë, datë 20.12.2005, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka kryer 3 (tre) tërheqje nga “Raiffeisen Bank” ShA, në datat 07.12.2005 dhe 08.12.2005, përkatësisht në shumat 2.800.000 lekë, 5.800 USD/605.810 lekë dhe 938.680 lekë, në total 4.344.990 lekë, ndërsa në datën 20.12.2005 është investuar prej tij në bono thesari shuma 3.130.000 lekë. Ndonëse nga dokumentacioni bankar nuk evidentohet ndonjë transaksion që vërteton se këto tërheqje kanë kaluar në Bankën e Shqipërisë për investim në bono thesari, nisur nga fakti se datat e tërheqjes janë të afërta, trupi gjykues nuk e përjashton as mundësinë që këto shuma të jenë përdorur për këtë qëllim. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, përmes Njësies së Shërbimit Ligjor në Kolegj, rezultoi që babai i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin e depozitës në “Raiffeisen Bank” ShA dhe për investimet në bono thesari. Në këto kushte, edhe interesat e përfituara nga këto fonde nuk do të konsiderohen si e ardhur e ligjshme në analizën financiare.

47. Subjekti i rivlerësimit pretendon se *në lidhje me huan në shumën 1.000.000 lekë, që babai i saj ka marrë nga shtetasi R. M., ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi ky shtetas kishte ndërruar jetë dhe ajo ishte në pamundësi për të paraqitur prova mbi mundësinë financiare të krijimit të kësaj shume. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet të hetonte drejtpërdrejt mbi burimet financiare të huadhënësit, pasi shuma prej 1.000.000 lekësh disponohej prej tyre, por ishte e bllokuar në bono thesari, me tërheqjen e të cilave i është kthyer huadhënësit.*
48. Në shqyrtim të këtij pretendimi, referuar akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se kjo hua është deklaruar<sup>36</sup> nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si një ndër burimet e krijimit për pagesën e këstit të parë të apartamentit objekt shqyrtimi, në vlerën 28.070 euro, paguar në datën 17.09.2007. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se babai i saj ka marrë hua në shumën 1.000.000 lekë nga miku i tij R. M., por pa u lidhur me asnjë deklaratë huaje, pasi kjo vlerë do t'i kthehej atij në një kohë të shkurtër, në kushtet që disponohej e investuar në formën e bonos së thesarit, e cila u thye në dhjetor të vitit 2007, kohë në të cilën është kthyer dhe huaja. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të vërtetuar mundësinë financiare të huadhënësit R. M. për dhënien e kësaj shume, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar<sup>37</sup> se ky shtetas ka ndërruar jetë në vitin 2019, por sipas shpjegimeve të babait të saj kjo shumë buronte nga të ardhurat e emigracionit të fëmijëve të tij. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur certifikatë të vdekjes së huadhënësit R. M., sipas së cilës ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 08.08.2019. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se lidhur me këtë hua ndodhet në kushtet pamundësisë objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi ajo është përpjekur për të gjetur dokumentacion, por në kushtet kur ai ka ndërruar jetë dhe bashkëshortja dhe disa nga fëmijët e tij jetojnë jashtë vendit ka qenë e pamundur sigurimi i këtij informacioni. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.02.2022, të shtetases F. R. K., vajza e huadhënësit R. M., në të cilën ajo ka deklaruar se ka qenë në dijeni të dhënies së kësaj huaje në vitin 2007 nga babai i saj, të ardhura të cilat ai i ka siguruar nga shitja e pasurive të paluajtshme

<sup>36</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

<sup>37</sup> Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

në qytetin e Pukës rreth vitit 2006 dhe të ardhura të familjes. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se i është drejtuar bankave për informacion mbi të ardhurat familjare në vitin 2007, por në mënyrë verbale i është kthyer se një informacion i tillë për periudha përpara se babai i saj të ndërronte jetë nuk mund të jepet, e madje një informacion i tillë nuk mund të jepet as me vendim gjykate.

49. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, pas thyerjes së bonove të thesarit në dhjetor të vitit 2007, trupit gjykues nuk i rezultojnë të dhëna mbi ndonjë transaksion financiar nga babai i subjektit të rivlerësimit apo familjarë të tjerë, lidhur me kthimin e shumës 1.000.000 lekë të huadhënësi R. M.
50. Bazuar në këtë situatë faktesh, në lidhje me huan në vlerën 1.000.000 lekë, trupit gjykues nuk i rezulton e provuar marrëdhënia e huas mes babait të subjektit të rivlerësimit B. H. dhe huadhënësit R. M., si dhe dhënia apo kthimi i shumës prej 1.000.000 lekësh. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 2<sup>38</sup> e ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova mbi mundësinë financiare të huadhënësit, për shkak se ai ka ndërruar jetë, vlerësohet si i pabazuar, pasi trupit gjykues nuk i rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur në Komision ndonjë dokument zyrtar që mungesën e informacionit mbi të dhënat financiare të shtetasit R. M. t'ia atribuojë paraqitjes së tij personalisht përpara institucioneve respektive. Edhe deklarata noteriale e vajzës së huadhënësit, në të cilën ajo, ndër të tjera, deklaron mbi pamundësinë për të siguruar informacion nga bankat mbi të ardhurat e babait të saj, nuk mbështetet nga ndonjë përgjigje zyrtare të këtyre institucioneve. Për këtë arsye, trupi gjykues, në linjë me Komisionin, vlerëson se shuma prej 1.000.000 lekësh e marrë hua nuk mund të përfshihet në mesin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi. Ndërsa sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, që Komisioni duhet të kishte hetuar vetë mbi mundësinë financiare të huadhënësit R. M., trupi gjykues sjell në vëmendje se barra e provës<sup>39</sup> në procesin e rivlerësimit kalimtar është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, të cilit i përket detyrimi për të provuar pretendimet e tij, duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim.
51. Bazuar në sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit, me qëllim verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit, prindërve, të vëllait dhe të motrës, për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi nën regjimin e një ekonomie të përbashkët familjare, për likuidimin e çmimit të porositjes së këtij apartamenti deri në fund të vitit kalendarik 2007, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën totale prej (-) 2.854.939 lekësh. Gjithashtu, vlen të theksohet fakti se nga analiza financiare e kryer në Kolegj, mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve për të kursyer në periudhën 1998-2003, rezulton se kontributi i subjektit ka qenë në masën 2.605.465 lekë, ndërsa kontributi i anëtarëve të tjerë të familjes në masën 275.518 lekë.
52. Në përfundim të analizës së mësipërme, duke analizuar faktin e mungesës së burimeve të ligjshme të

---

<sup>38</sup> Neni 32, pika 2, parashikon: "[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...]".

<sup>39</sup> Sipas parashikimeve të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës në procesin e rivlerësimit i kalon subjektit të rivlerësimit.

subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj për të blerë këtë pasuri, rrethanat që kanë rezultuar nga hetimi administrativ, sikurse pasqyruar në paragrafin 37 të këtij vendimi, si dhe faktin që kontributi i subjektit të rivlerësimit përbën pjesën dërrmuese të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj, Kolegji arrin në përfundimin se kjo është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, të cilën ajo është përpjekur fillimisht të mos e deklarojë dhe më pas ta paraqesë si një pasuri që u përket prindërve të saj dhe se ajo nuk gëzon të drejta mbi të, pavarësisht se është kontribuuesja kryesore e saj, duke u gjendur në këtë mënyrë në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

***Në lidhje me konstatime të tjera mbi depozita dhe derdhje të babait të subjektit të rivlerësimit***

53. Komisioni, referuar të dhënave bankare të babait të subjektit të rivlerësimit, ka evidentuar disa depozita dhe derdhje bankare në “Raiffeisen Bank” ShA dhe në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, si vijojnë: (i) depozitë në “Raiffeisen Bank” ShA, që vjen me një tepricë me vlerë 1.341.894 lekë, në datën 30.09.2004; (ii) depozitë në “Raiffeisen Bank” ShA, që vjen nga një tepricë me vlerë 919.637 lekë, në datën 25.02.2005; (iii) derdhje në llogari në “Raiffeisen Bank” ShA të vlerës 2.786.122 lekë në datën 07.12.2005; (iv) derdhje në depozitë në “Raiffeisen Bank” ShA të vlerës 5.800 USD në datën 05.09.2005; (v) derdhje në llogari në “Raiffesien Bank” ShA të vlerës 340.000 lekë, në datën 17.01.2007; (vi) derdhje në llogari në “Raiffeisen Bank” ShA të vlerës 1.000.000 lekë, në datën 07.06.2011; (vii) depozitë në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA në vlerën 1.400.000 lekë, në datën 12.6.2012 dhe shtesave të tjera në këtë depozitë nga derdhje të mëvonshme; (viii) depozitë bankare pranë ish-Bankës Amerikane në vlerën 6.000 USD.
54. Në lidhje me këto depozita dhe derdhje në llogari bankare, Komisioni ka arritur në konkluzionet si vijojnë: (i) subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion justifikues ligjor mundësinë e krijimit të këtyre depozitave dhe derdhjeve në llogarinë bankare; (ii) subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me këto likuiditete.
55. Nga kontrolli i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni kontrollin mbi burimet e ligjshme për krijimin e depozitave bankare nga babai i subjektit të rivlerësimit e ka bazuar në analizën vjetore të kryer për periudhën 1996 – 2007. Nga kjo analizë e Komisionit ka rezultuar se në vitet 2004 dhe 2005 subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme përkatësisht në vlerat (-) 1.421.967 lekë dhe (-) 980.983 lekë.
56. Në ankim, subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se ka shpjeguar bindshëm mundësinë e krijimit të këtyre depozitave për çdo vit, nga viti 2003 deri në vitin 2016, ka parashtruar se [...] depozita në “Raiffeisen Bank” ShA, që vjen me një tepricë prej 1.341.894 lekësh në datën 30.09.2004 e ka burimin nga kursimet familjare, që siç u shpjegua më lart por edhe nga vetë analiza e kryer nga Komisioni, rezultonte një gjendje monetare në fillim të vitit 2004 në shumën 3.759.981 lekë. Kjo gjendje në fillim të vitit 2004 justifikon dhe mbulon jo vetëm këtë depozitë, por edhe depozitën tjetër në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 6.009,32 USD. Të dy këto depozita në vitin 2004 arrijnë në vlerën pas konvertimit me kursin e kohës në shumën 1.923.944 lekë. Në vitin pasardhës 2005, kemi të bëjmë me të njëjtat depozita në “Raiffeisen Bank”, të cilat tërhiqen dhe depozitohen në bono thesari në Bankën e Shqipërisë. Depozita në datën 7.12.2005 në RZF është mbyllur dhe tërhequr për tu depozituar në Bono Thesari në të njëjtën datë në shumën 2.800.000 lekë. Kujtoj që më datë 1 janar 2005 gjendje likuiditetesh në familje

rezultojnë 3.067.166 lekë. Derdhje në depozitë në “Raiffeisen Bank”, të vlerës 5.800 USD, në datën 5.09.2005 duhet ta ketë origjinën nga tërheqja e depozitës në USD të shumës 6000 USD në bankën “Intesa Sanpaolo” më lart përmendur. Derdhja në vitin 2007 e depozitës të vlerës 340.000 lekë në datën 17.01.2007 është nga gjendja e likuiditeteve cash në familje. Gjendja cash në fillim të atij viti ishte në 3.132.829 lekë. Depozitat e tjera të vitit 2011 e kanë burimin, gjithashtu, nga gjendja e cash-it në familje. Depozita në “Raiffeisen Bank”, e vitit 2011, në shumën 1.000.000 lekë, është kaluar në një depozitë tjetër në vitin 2012 te “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 1.400.000 lekë, e cila më pas është shtuar dhe është kaluar në një depozitë në vitin 2013 në shumën 2.000.000 lekë. Depozitat dhe llogaritë bankare janë të lidhura njëra me tjetrën dhe lehtësisht kuptohet që burimet i kanë edhe nga kalimet e njëra tjetrës. Gjithsesi gjendjet e likuiditeteve të cash-it në familje janë të konsiderueshme dhe të mjaftueshme për të justifikuar depozitat.

56.1 Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, referuar të dhënave të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit i pyetur mbi burimin e ligjshëm të depozitave dhe derdhjeve të mësipërme, ka deklaruar se: <sup>40</sup> [...] të gjitha depozitat dhe derdhjet e bëra nga babai, B. H., në bankat e mësipërme janë krijuar nga kursimet ndër vite nga paga dhe pensionet e prindërve B. dhe R. H., nga të ardhurat e krijuara nga puna e babait në sektorin privat, nga interesat bankare, si dhe kontributi nga të ardhurat nga paga ime, kontributi nga paga i vëllait, të ndjerit S. H. dhe kontributi nga të ardhurat nga paga të motrës, A. H. Sipas shpjegimeve të babait, një pjesë e derdhjeve/depozitave të mësipërme janë krijuar si rezultat i lëvizjeve ndërmjet bankave për shkak të interesave, për të cilat po kërkohet informacion në bankat e mësipërme. Ndërsa, për sa i përket të ardhurave nga puna e babait si topograf po kërkohet informacion në institucionet ku janë kryer projektet dhe do të dërgohet sapo të na vihet në dispozicion. Në bazë të vërtetimeve të të ardhurave nga paga dhe të ardhurave të tjera, të anëtarëve të familjes, rezulton se kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Në lidhje me depozitën tek ish-Banka Amerikane ShA, e krijuar në vitin 2004 në vlerën 6.000 USD nga babai B. H. dhe periudhën e tërheqjes, subjekti ka sqaruar se: [...] Sipas shpjegimeve të babait shuma e mësipërme e depozituar në ish-Bankën Amerikane ShA, rrjedh nga vlera e projekteve të realizuara nga babai, B. H., për llogari të Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Institutit të Pronave, sikurse janë detajuar në deklaratën noteriale, për të cilat po vazhdojmë të kërkojmë dokumentacion provues dhe do të dërgohet sapo të na vihet në dispozicion. Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumente mbi të ardhurat nga pagat të pjesëtarëve të familjes ndër vite<sup>41</sup>.

56.2 Në përfundim të hetimit administrativ, për depozitën në “Raiffeisen Bank” ShA, që vjen me një tepricë prej 1.341.894 lekësh në datën 30.09.2004 dhe depozitën në “Raiffeisen Bank” ShA, që vjen nga një tepricë prej 919.637 lekësh në datën 25.02.2005, Komisionit i rezultoi se informacioni bankar që vjen në lidhje me këto dy depozita nuk qartësonte momentin e saktë të krijimit të tyre. Ndërsa lidhur me

<sup>40</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 4 të Komisionit.

<sup>41</sup> Vërtetim nr. {\*\*\*}, datë 23.11.2021, për trajtimin me pension pleqërie, për nënën R. H.; vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, për periudhën 1996-2007, për nënën, R. H.; vërtetime për bazën e vlerësueshme, për periudhat 2000-2002, 2005-2006 dhe 2012-2015, për vëllain, S. H.; vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 23.12.2021, për vjetërsi në punë dhe trajtim financiar, për vëllain S. H.; vërtetime për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 2003-2013, për të motrën, A. H.



depozitën tek ish-Banka Amerikane ShA, e krijuar në vitin 2004, në vlerën 6.000 USD nga babai B. H., Komisioni, referuar të dhënave bankare të ish-Bankës Amerikane ShA, ka konstatuar se kjo depozitë ishte e krijuar në shtator të vitit 2004 dhe në dhjetor të vitit 2004 kjo depozitë maturohet në vlerën 6.009,32 USD, por nuk qartësohet nëse kjo shumë tërhiqet në fund të vitit apo lihet gjendje. Në analizën financiare të Komisionit kjo vlerë prej 6.009,32 USD është lënë gjendje në fund të vitit 2004. Për këto arsye, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar periudhën e krijimit të këtyre depozitave dhe burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

**56.3** Në sqarimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit administrativ në lidhje me burimin e krijimit të këtyre derdhjeve që kanë qenë nga kursimet ndër vite, nga paga dhe pensionet e prindërve B. dhe R. H.; nga të ardhurat e krijuara nga puna e babait në sektorin privat; nga interesat bankare; nga kontributi nga të ardhurat nga paga ime; kontributi nga paga i vëllait, të ndjerit S. H. dhe kontributi nga të ardhurat nga paga të motrës, A. H. Sipas subjektit të rivlerësimit, referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni, diferenca pozitive e rezultuar në fund të vitit 2002 në shumën 2.235.381 lekë, është e mjaftueshme për të shpjeguar edhe depozitimet e kryera nga babai në “Raiffeisen Bank” ShA dhe “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, pa marrë në konsideratë të ardhurat dhe kursimet familjare në vitet 2003, 2004 dhe 2005.

**56.4** Nga verifikimi i informacionit bankar të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ<sup>42</sup>, trupi gjykues konstaton se:

(i) në lidhje me shumat 1.355.583 lekë, 919.637 lekë dhe 6.000 USD rezultojnë llogaritë dhe depozitat si vijojnë: (a) llogari bankare nr. {\*\*\*}, në emër të B. H. pranë “Raiffeisen Bank” ShA, e cila fillon me një tepricë prej 1.341.894 lekësh të datës 30.09.2004 dhe në fund të vitit 2004, pas përfitimit të interesave, është 1.355.583 lekë; (b) depozitë në shumën 6.000 USD, e krijuar më 19.09.2004, për të cilën është e paqartë nëse vlera e fundit e maturuar në dhjetor 2004 është gjendje në fund të vitit apo tërhiqet, si dhe destinacioni i kësaj shume. Kjo shumë, ashtu sikurse dhe Komisioni, u konsiderua gjendje në fund të vitit 2004; (c) llogari bankare nr. {\*\*\*}, në emër të B. H. pranë “Raiffeisen Bank” ShA, e cila fillon me një tepricë prej 919.637 lekësh të datës 25.02.2005 investuar në depozitë me datë maturimi 25.09.2005 në shumën 933.827 lekë. Në mungesë të të dhënave mbi kohën dhe burimin e krijimit të këtyre shumave, si dhe gjurmëve të mëparshme në lëvizjet e llogarive bankare, trupi gjykues kreu analizën financiare në datën e konstatimit të tepricave në llogaritë bankare të B. H. dhe jo në momentin e krijimit të tyre, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë pasur mundësi nga burime financiare të ligjshme për të krijuar këto depozita deri në datën 30.09.2004. Në eventualitetin që kontributi i subjektit të rivlerësimit nuk do të përlllogaritej në këtë analizë, familjarët e saj do të rezultonin me pamjaftueshmëri për krijimin e këtyre depozitave me burime financiare të ligjshme në shumën (-) 1.463.321 lekë.

(ii) në lidhje me shumën 919.637 lekë, gjendje në llogarinë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit në datën 25.02.2005, për të cilën nuk ka të dhëna kur është krijuar kjo shumë apo nga buron, nga analiza financiare e kryer në datën e konstatimit të tepricës, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e

---

<sup>42</sup> Shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 06.05.2020, nga “Raiffeisen Bank” ShA dhe shkresë kthim përgjigje nr. {\*\*\*} prot., datë 12.05.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank” ShA.

saj nuk kanë pasur mundësi për krijimin e kësaj shume me burime financiare të ligjshme, duke rezultuar më një balancë negative prej (-) 572.122 lekësh.

(iii) në lidhje me shumën 2.786.122 lekë, arkëtuar *cash* nga z. B. H. në llogarinë bankare pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në datën 05.09.2005<sup>43</sup>, rezulton se po në këtë datë është bërë tërheqje nga depozita e maturuar në datën 01.09.2005, në shumën 1.391.122 lekë, e cila rrjedh nga teprica bankare e datës 30.09.2004 (1.341.894 lekë). Nisur edhe nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ se një pjesë e arkëtimeve/depozitave janë krijuar si rezultat i lëvizjeve bankare për shkak të interesave, nuk përjashtohet mundësia që shuma 2.786.122 lekë të jetë krijuar nga tërheqja e depozitës 1.391.122 lekë dhe diferenca prej 1.395.000 lekësh të jetë likuiditet *cash*, pasi nuk ka gjurmë për kalime apo tërheqje në shumën të ngjashme. Referuar të dhënave të llogarive bankare konfirmohet se kjo shumë është tërhequr *cash* në datën 07.12.2005. Nga analiza financiare mbi mundësinë e krijimit të shumës 1.395.000 lekë, në datën e arkëtimit më 05.09.2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj nuk kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj shume.

(iv) në lidhje me shumën prej 340.000 lekësh, arkëtuar *cash* nga z. B. H. në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në datë 17.01.2007, rezulton se po në të njëjtën datë është investuar në depozitë 1-vjeçare, më pas është tërhequr *cash* në datën 22.01.2008, por destinacioni është i paqartë. Nga analiza financiare mbi mundësinë e krijimit të shumës 340.000 lekë të arkëtuar në datën 17.01.2007, rezulton se subjekti rivlerësimit dhe familjarët kanë pasur mundësi për krijimin e kësaj shume me burime financiare të ligjshme.

(v) në lidhje me shumën 1.000.000 lekë, arkëtuar në llogarinë pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në datën 07.06.2011 dhe shumën 1.400.000 lekë, depozitë pranë “Raiffeisen Bank” ShA, në datën 12.06.2012, si dhe shtesa të tjera në këtë depozitë nga arkëtime të mëvonshme, rezulton se shuma prej 1.000.000 lekësh e investuar në depozitë 1-vjeçare është tërhequr *cash* në datën e maturimit 07.06.2011 dhe është arkëtuar *cash* në “Intesa Sanpaolo Bank” ShA, së bashku me shtesa të tjera në shumën totale prej 1.400.000 lekësh, me përshkrimin “Kursime nga një bankë tjetër”. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, vihet re se për periudhën 2008 – 2016, brenda së cilës janë krijuar edhe këto dy depozita, nuk rezulton ndonjë pamundësi financiare.

56.5 Bazuar në sa më sipër analizuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për të krijuar depozitat dhe llogaritë e mësipërme në emër të babait, z. B. H., për shkak të balancave negative në vitet 2004 dhe 2005.

57. Përveç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka ngritur edhe disa pretendime mbi mospërfshirjen në analizën financiare të disa të ardhurave të pretenduara prej saj edhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, që trajtohen në vijim:

57.1 Në lidhje me pretendimin se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit në vitin 1998 në shumën 119.793 lekë, pasi paga e saj në këtë vit ka qenë 257.555 lekë dhe jo 137.762 lekë, siç pasqyrohet nga Komisioni, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi

---

<sup>43</sup> Komisioni në vendim ka konstatuar arkëtimin në datën 07.12.2005, por bazuar në lëvizjet bankare të “Raiffeisen bank”, arkëtimi është kryer në datën 05.09.2005 dhe në datën 07.12.2005, babai i subjektit i ka tërhequr këto fonde.

gjykues konstaton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për vitin 1998 janë llogaritur në masën 137.762 lekë. Kjo vlerë i referohet vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë. 09.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në dosjen e ILDKPKI-së, sipas së cilit për periudhën 01 shtator – 31 dhjetor 1998, subjekti ka përfituar pagën *neto* 128.762 lekë + 9.000 lekë shpërblime = 137.762 lekë. Vërtetimet me nr. {\*\*\*} prot., datë 03.02.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, mbi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003 – 2007 dhe 2014 – 2020, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit nuk japin informacion mbi pagat e vitit 1998. Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson si të pambështetur në prova këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

**57.2** Në lidhje me pretendimin se *nuk janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e të vëllait, i punësuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë në shumën 3.992.267 lekë*, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues konstaton se të ardhurat e të vëllait nga punësimi pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë janë llogaritur në vlerën 3.992.267 lekë, vlerë kjo e referuar në vërtetimet mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare për periudhat 2006 – 2011 dhe 2015 – 2021, nga punëdhënësi Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, të administruara edhe në dosjen e Komisionit, të paraqitura sërish nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit.

**57.3** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *për periudhën deri në fund të vitit 2002, nuk janë përfshirë të ardhurat e vëllait në shumën 188.764 lekë nga punësimi i tij pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, të cilat nga 435.230 lekë të përlllogaritura nga Komisioni duhet të ishin 623.994 lekë*, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues konstaton se të ardhurat e vëllait S. H. për periudhën deri në fund të vitit 2002 janë përlllogaritur në vlerën *neto* prej 435.230 lekësh, referuar vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme nr. {\*\*\*} prot., datë 08.10.2021, nga punëdhënësi “Drejtoria e Policisë Tropojë”, i depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ<sup>44</sup>. Sikundër arsyetuar më lart, të ardhurat shtesë në vlerë *bruto* 188.764 lekë, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për punësimin e vëllait S. H. pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, nuk u përfshinë në analizë financiare.

- 58.** Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues, përmes Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kontrolloi analizën financiare të periudhës 1996 – 2007, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve në vitet 2004, 2005 dhe 2007 përkatësisht në shumat (-) 1.421.967 lekë, (-) 980.983 lekë dhe (-) 2.854.939 lekë, në shumën totale prej (-) 5.257.889 lekësh, duke u gjendur në kushtet e parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- 59.** Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

---

<sup>44</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 513, datë 25.02.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 513, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Flutura Hoxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 16.07.2024, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*